



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Ismail Qemali”,
Vlorë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Drini SALKO

2. Prof.As. Artur RIBAJ

Maj/2020

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, (UV), i krijuar me VKM dt.28.02.1994, ushtron veprimtarinë akademike shkencore bazuar në Ligjin Nr 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor për IAL-të në Republikën e Shqipërisë, dhe në këtë vit akademik filloi aktivitetin me tre Fakultete, ku një prej tyre ishte Fakulteti i Tregtisë . Ky i fundit gjate viteve të mëvonshme u zgjeruar me staf akademik të kualifikuar dhe me programe të reja duke u shndërruar në Fakultetin e Ekonomisë që aktualisht ka një staf akademik prej 33 anëtarësh. në strukturën e Fakultetit të Ekonomisë përfshihen tre Departamente:

- Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit
- Departamenti i Ekonomiksit
- Departamenti i Biznesit

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit i krijuar në dt.16.09.2008 është njësia bazë mësimore–kërkimore përgjegjëse e këtij programi që përfshin fushën e kërkimit në Financë dhe Kontabilitet duke përfshirë këto disiplina përkatëse.

Programi i studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Financë” është hapur me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 124, datë 17.02.2010

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit është njësia bazë përgjegjëse për 2 programe studimi të nivelit Bachelor në “Finance” dhe “Kontabilitet” si dhe të dy programeve të studimit Master Profesional dhe Master i Shkencave në po këto drejtime.

Programi organizohet sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe për të fituar këtë diplomë duhen 180 kredite (ECTS). Forma e studimit në programin e studimit Bachelor në “Financë” është me kohë të plotë dhe e organizuar në mënyrë të kujdesshme, për të harmonizuar të gjithë komponentët e tij, duke respektuar legjisllacionin në fuqi lidhur me organizimin e programeve të studimit (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018).




Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Realizimi i procesit të vlerësimit të jashtëm u mbështet në një seri dokumentesh dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standardet dhe mënyrën e funksionimit të njërive përkatëse që mbulojnë këtë program. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbeu Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i cili ishte rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ dhe pasqyrore situatën e procesit të formimit dhe të zhvillimit në Fakultetin e Ekonomisë, Departamentin e Financës dhe Kontabilitetit. Një rol të rëndësishëm në këtë vlerësim ka dhe vizita në vend që u realizua pranë Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, Fakultetit të Ekonomisë/ Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit në datat 24-25 Shkurt 2020, takimet me drejtues të këtij institucioni si dhe shqyrtimi i dokumentacionit bazë mbi të cilin organizohet i gjithë programi i studimit.

Gjatë vizitës në vend u realizuan takime me drejtues të Institucionit, me drejtues të Departamentit, Njësinë e Vlerësimit të Brendshëm, stafin pedagogjik, studentë, sekretarinë mësimore, administratën, arkivin, bibliotekë etj. Gjithashtu u bë vizitë në mjediset mësimdhënëse të këtij Institucioni, në sallën e kompjuterave, si dhe u zhvillua bashkëbisedim me studentë të disa grupeve. Theksojmë se në të gjitha takimet dhe vizitat në ambientet e institucionit gjetëm bashkëpunim të plotë lidhur me punën tonë.

Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, me të dhënat e studentëve në sekretari, me të dhënat për hyrje dhe dalje të studentëve në vite dhe lidhur me frekuentimin e leksioneve dhe të seminareve.

Gjithashtu gjykimi i grupit të vlerësimit të jashtëm u mbështet në evidentimet me zgjedhje të dokumentacionit në hallka të veçanta të institucionit si sekretarinë mësimore, laboratorin e informatikës, bibliotekës së universitetit, punonjës të administratës, etj.

Gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL.

Më datë 27.04.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 30/40 Prot., datë 27.04.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 04.05.2020.

Shënim: Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm, ka ardhur si pasojë pandemisë së COVID-19. Komunikimi me IAL është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132, datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91, dt. 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190, datë 19.03.2020.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi I.3 Kriteri 2**,

GVJ konkludon qe Raporti në këtë pikë nuk ndryshon pasi gjate vitit 2019 përpjekja e Departamentit përgjegjës për këtë program për të ndërmarre studimin mbi tregun e punës (që nga viti 2011 qe është bere studimi i fundit) është sipërfaqësore dhe ende në proces.




2. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi I.3 Kriteri 3 dhe Standardi 1.5 Kriteri 4,**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon pasi e konsideron praktiken profesionale në program te rëndësishme dhe të pazëvendësueshme me asnjë element tjetër të programit.

3. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi I.5 Kriteri 3,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon pasi opinionin e tij i referohet përgatitjes nga vetë stafi përfitues i informacionit lidhur me eksperiencën e fituar nga mobilitetet e përfituara pranë universiteteve partnere

4. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.1 Kriteri 4,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon pasi propozimet lidhur me lëndët e përmendura bazohen në praktikën më të mira të kurikulave në këtë program dhe në synimin e rritjes për marrjen e njohurive profesionale konform një programi të nivelit të ciklit të parë.

5. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.3 Kriteri 7,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë ndryshon pjesërisht vetëm paragrafi mbi mungesën e nënshkrimit në syllabus nga Përgjegjësi i Departamentit (pasi nuk parashikohet në rregulloren përkatëse të institucionit) dhe që tashme konsiderohet si sugjerim i GVJ (shih raportin).

6. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi III.1 Kriteri 2 dhe Standardi III.4 Kriteri 1,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë ndryshon duke saktësuar emërtimet e njësive përgjegjëse që mbulojnë mesimdhënien dhe nivelin e cilësisë së saj (shih raportin).

7. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi III.2 Kriteri 2,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon pasi rekomandimi ynë reflekton stafin relativisht të ri të këtij programi studimi ku pesha e stafit me tituj akademik është e ulët.

8. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi III.6 Kriteri 4,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon pasi rekomandimi mbi sekretimin e zhvillimit të provimeve ul mundësinë e vlerësimeve subjektive dhe të pamerituara, praktike kjo tashmë e përdorur rëndom në universitete.

9. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.1 Kriteret 2, 3, 4,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon. Komentet e dërguara nga IAL nuk sjellin asnjë argument apo fakt për tu konsideruar dhe ndryshuar konstatimet e GVJ-së të faktuara edhe gjatë vizitës në IAL dhe cituar në RVJ duke dhënë edhe specifikime. UV ka potenciale të krijuara prej një historie mbi 25 vjeçare dhe si e tillë nuk duhet të ngelet të rekrutoj PAE pa grada dhe tituj apo të ketë përgjithësisht 2 apo 3 kandidatë për një pozicion punë të shpallur për PAE, ndërsa duhet të kishte me dhjetëra aplikantë potencial. Ka eksperiencë nga IAL publike të maturuara në Shqipëri apo jashtë saj ku UV mund të mësojë rreth përcaktimit të

kritereve të përgjithshme dhe ato të veçanta për kategoritë asistent lektor, lektor dhe profesor. Kjo përjasje e ndihmon njësinë bazë dhe IAL-në për arritjen e objektivave të tyre lidhur me këtë program studimi.

Për komentin tjetër lidhur me rrugën që ndjek procesi i miratimit të kritereve për rekrutim të stafit, Njësia bazë lë të kuptohet se kriteret e miratuara prej tyre kalojnë për miratim vetëm tek Rektori pa qënë nevoja e miratimit të tyre nga Dekani ndërkohë që gjatë seancave në vizitat në vend dhe disa dokumentave të dorëzuara u evidentua tjetër proces nga çfarë ka përcaktuar statuti i IAL-së.

10. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi III.2 Kriteri 4 dhe Standardi IV.2 Kriteri 4.**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon. Komentet e dërguara nuk i përgjigjen pikurës së plotë të përcjell për këto kritere në RVJ dhe referencave të saj me qëllim rritjen e cilësisë së këtij programi studimi dhe si rezultat rritjen e numrit të studentëve përmes rritjes së cilësisë në mësimdhënie, projekte kërkimore, zhvillimore, etj., por ato fokusohen vetëm tek ato fjali që mund të çënojnë dikë prej tyre.

11. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.3 Kriteret 3, 4, 5,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon. Komentet nuk sjellin ndryshim të konstatimeve të GVJ-së lidhur me laboratorët dhe ambientet rekreative të shoqëruar me akses në internet për studentët.

12. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.6 Kriteri 5,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon. Komentet nuk kanë lidhje me sjelljen e fakteve dhe argumenteve për kërkesat e këtij kriteri por janë fokusuar tek pjesa vizuale e tendencës e cila është vendosur për ilustrim qëllimisht për të nxitur IAL-në të mendojë si të kryejë analiza shkencore dhe të ndërtojë strategjitë e duhura për kapërcimin e vështirësive ku ndodhet ky program studimi. *(Bazuar në regjistrimet faktike të studentëve ka rënie të theksuar për të tretin vit radhazi në këtë program studimi dhe së fundmi studentët e regjistruar në vitin akademik 2019-2020 janë sa 38% e studentëve të regjistruar në vitin akademik 2016-2017).*

13. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi VI.1,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë ndryshon pjesërisht, pasi pavarësisht komenteve të dërguara, matërialiteti qëndron tek konstatimet e tjera të GVJ-së për të cilat nuk janë dërguar argumente apo fakte shtesë. Megjithatë GVJ e ka vlerësuar në RVJ progresin e bërë nga IAL lidhur me transparencën dhe kujdesin që po tenton të ushtrojë këto vitet e fundit për rritjen e cilësisë së programeve mësimore. (shih raportin).

14. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi VI.2**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon pasi komentet e sjella nuk bazohen në një analizë tregu (analiza më e fundit e tregut është bërë në vitin 2011) apo në një analizë të rekomandimeve të marra nga ALUMNI apo bizneset të cilat nëse do të ekzistonin do të ishin referuar dhe bashkëlidhur RVB-së.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, (UV), i krijuar me VKM dt.28.02.1994, ushtron veprimtarinë akademike shkencore bazuar në Ligjit Nr 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor për IAL-të në Republikën e Shqipërisë, Statutit të tij dhe Planit Strategjik 2018-2024 të miratuar dhe zhvillon programe universitare të cilat nuk bien ndesh me interesat kombëtare por që i shërbejnë këtyre interesave. <i>(Evidenca A dhe B)</i>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në “Financë” bazohet në vlerat akademike e kulturore kombëtare rrjedhoje kjo e një Universiteti tashmë me historik relativisht të gjatë dhe eksperiencë të pasur. <i>(Evidenca A dhe B)</i>
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në “Financë” bazohet në misionin, qëllimin objektivat të përcaktuara qartë nga Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, (UV), të bazuara në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi, në Statutin e tij si dhe në Strategjinë afatmesme të hartuar nga Institucioni. Misioni i këtij program studimi është të arrijë të përgatisë staf potencial të kualifikuar kryesisht në fushën e veprimtarisë financiare, por edhe më gjerë. Ky program njëkohësisht është ndërtuar që të përmbushë dhe misionin e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit si Njësia Bazë që mbulon këtë program. <i>(Evidenca A dhe B)</i>
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Njohuritë teorike dhe praktike të fituara nëpërmjet këtij programi do mundësojnë plotësimin e tregut të punës në sektorin financiar dhe bankar kryesisht në kuadrin lokal dhe rajonal por edhe më gjerë. Studentët e këtij programi synohet të përftojnë njohuritë e nevojshme për tu punësuar kryesisht në tregun financiar lokal me njohuri për ekonominë shqiptare, financën menaxhimin financiar dhe bankë. Me përfundimin e programit përkatës arrihet që studenti të pajiset me aftësi si: <ul style="list-style-type: none"> ➤ Zotërimi i njohurive bazë teorike dhe deri diku praktike të problemeve financiare duke u dhënë mundësi ➤ Te gjejnë veten në tregun e punës në sektorin financiar e

	<p>bankar në pozicione bazë të tilla si ekonomiste të financës, në sektorin publik e privat të ekonomisë, arkëtarë apo shërbim llogarie pranë bankave tregtare lokale dhe rajonale, institucioneve të sigurimit etj.</p> <p>➤ Zotërimi i njohurive bazë mësimore dhe deri diku shkencore për të qënë të suksesshëm në vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë të programeve universitare atë të Masterit Shkencor apo Masterit Profesional.</p> <p>Aftësitë e marra në fushën e financës dhe bankës janë një bazë e fuqishme për të qënë të sukseseshëm në tregun lokal e rajonal të punës duke kontribuar kështu në zhvillimin ekonomik.</p> <p><i>(Evidenca A dhe B)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Programet e studimit në shtyllat kryesore të tyre bazohen në strategjinë e zhvillimit të UV 2008-2017 dhe Planin Strategjik e Zhvillimit 2018-2024, që përcakton hartimin dhe zbatimin e programeve të përshtatshme bazuar në sfidat e ekonomisë së tregut dhe pajisjen e studentëve me njohuritë që u lehtësojnë qasjen në tregun e punës. Nga ana tjetër, ky program me konkretisht bazohet në Planin Strategjik të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit dhe Planin Strategjik të vetë programit.</p> <p>Strategjitë përcaktojnë hapat e zhvillimit të mëtejshëm dhe mundësinë e rritjes më tej të cilësisë së mësimdhënies, rritjen cilësore të stafit akademik, konkurrencën në tregun e punës dhe vazhdimësinë e këtij programi në dy nivelet e tjera të programit në fushën e financës.</p> <p><i>(Aneksi nr. 1.1, 1.2; Evidenca B)</i></p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Drejtimit prioritar dhe akademike të programit të studimit Bachelor në “Financë” bazohen së pari në dokumentet themelor të UV që janë Statuti dhe rregullorja e tij të cilat janë në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit. Në nenin 37 të rregullores së Institucionit përcaktohet se programet e studimeve të ciklit të parë synohet të japin njohuri baze mbi metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet të gjërë profesionesh.</p> <p>Drejtimit prioritar të programit trajtohen më gjerë edhe në</p>

	<p>rregulloren e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit dhe rregulloren e vetë programit.</p> <p>Programi bazohet tashmë në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit Bachelor në “Financë”, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira bashkëkohore brënda fushës së financës dhe në funksion të qëllimit të tij.</p> <p><i>(Evidenca B dhe C)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Kriteret kryesore lidhur me emërtimin, organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit i përcakton rregullorja e UV në të cilën janë reflektuar edhe ndryshimet, rrjedhoje e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi. Nga ana tjetër, këto elemente të programit të studimit përcaktohen dhe bëhen me konkrete në rregulloren e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit dhe rregulloren e këtij programi. Në këto dokumente sanksionohet emërtimi i programit në fushën akademike që mbulon institucioni (Financë); organizimi i programit me një kohëzgjatje 3 vite akademike dhe 180 kredite si dhe përmbajtja e programit me lëndë që plotësojnë kriteret e një programi të nivelit Bachelor.</p> <p><i>(Evidencat B dhe C)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.3</p> <p>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në “Financë” bazohet në misionin, qëllimin dhe objektivat të përcaktuara qartë nga UV nëpërmjet statutit të tij.</p> <p>Objektivat e këtij programi studimi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Përgatitjen e studentëve me njohuri bazë dhe profesionale në fushën e financave, me mundësi punësimi në këtë sektor. ➤ Pajisjen e studenteve që përfundojnë këtë program me njohuritë e nevojshme për të vazhduar ciklin e dytë të studimeve në programin Master. <p>Njohuritë teorike praktike të fituara nëpërmjet këtij programi do mundësojnë plotësimin e tregut të punës në sektorin financiar në tregun lokal dhe rajonal por edhe më gjerë. Studentët e këtij programi synohet të përftojnë njohuritë e nevojshme për tu punësuar kryesisht brenda vendit për shkak të formimit teorik, njohurive për ekonominë shqiptare, financë kontabilitetin, dhe njohurive teorike në</p>

	<p>drejtimin financiar.</p> <p>Me përfundimin e programit përkatës arrihet që studenti të arrije:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Zotërimin e njohurive bazë teorike dhe deri diku praktike të problemeve financiare e bankare duke u dhënë mundësi të gjejë veten në tregun e punës në sektorin financiar e bankar në pozicione bazë të tilla si ekonomistë të financës, në sektorin publik e privat të ekonomisë, arkëtarë apo shërbim llogarie pranë sipërmarrjes private, bankave tregtare, institucioneve të sigurimit etj. ➤ Zotërimin e njohurive bazë mësimore e shkencore për të qënë të suksesshëm në vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë të programeve universitare atë të Masterit Shkencor apo Masterit Profesional. ➤ Aftësitë për të përdorur teoritë bazë dhe instrumentet financiare për të zgjidhur problemet e shfaqura në fushën financës dhe bankës. <p>(Aneksi nr. 1.2, 1.4, 1.5)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe takimet në institucion rezultojnë që studimet mbi tregun e punës janë realizuar nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Studimit të realizuar në vitin 2011 nga Fakulteti i Ekonomisë nëpërmjet Departamentit të Ekonomiksit, anëtarët e të cilit fituan projektin "Impakti në punësim i kurrikulave të nivelit të parë të studimeve pranë Fakultetit të Ekonomisë të UV- së "Ismail Qemali". Nëpërmjet këtij studimi u analizuan diplomat që ofronte institucioni ku përfshihej edhe programi Bachelor në "Financë". ➤ Organizimi nga Drejtorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve i një workshopi në Dhjetor 2019 me temë, "Studentët dhe Tregu i Punës" ku pjesëmarrës ishin nga UV dhe institucione publike apo njësi ekonomike private. Kjo nisëm duhet konsideruar si një drejtim i rëndësishëm lidhur me marrjen e informacionit nga tregu i mundshëm i punës si dhe tërheqja e mendimeve nga punëdhënësi të mundshëm. <p>Një përpjeke e Departamentit është edhe kërkesa e tij pranë bankave tregtare për të marrë informacion mbi të punësuarit pranë tyre të studentëve të Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p><i>Pavarësisht nga sa me sipër, mendojmë se Institucioni dhe para së gjithash Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit duhet të bëjnë përpjekje për të realizuar studime të plota për tregun e punës lokal, rajonal dhe deri diku edhe kombëtare për studentet e këtij programi. Ky studim është akoma edhe me i rëndësishëm sot në kushtet e rritjes së konkurrencës në treg dhe kur trendi i numrit të</i></p>

	<p><i>studentëve edhe në këtë program ka pësuar ulje gjatë viteve të fundit.</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 1.3, 1.10)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Financë” ofron për studentët lëndë të formimit të përgjithshëm dhe lëndë të specialitetit në financë dhe deri diku edhe në kontabilitet. Disa prej tyre synojnë të kenë edhe karakter praktik me qëllim që studentët të përshtatën me tregun e punës. Ky program është reflektim edhe i praktikave dhe eksperiencave tashme të krijuara në hartimin e programeve të nivelit Bachelor në Financë dhe që mban parasysh edhe kërkesat në rritje në tregun e punës në këtë sektor për specialistët e financës.</p> <p><i>Megjithatë, mos përfshirja e praktikës mësimore në këtë program përben një mangësi lidhur me ngritjen e aftësive profesionale të studentëve dhe mundësimin e tyre në tregun e punës edhe nëse një i diplomuar në këtë program do i drejtohej këtij tregu. Mendojmë se futja në program e praktikës profesionale është domosdoshmëri edhe si një urë lidhëse mes studentëve që janë drejt përfundimit të këtij programi dhe tregut të punës.</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 1.4)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi I.4</p> <p>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, është krijuar me VKM nr.105 datë 28.02.1994 dhe në këtë vit akademik filloi aktivitetin me tre Fakultete, ku një prej tyre ishte Fakulteti i Tregtisë . Ky i fundit gjatë viteve të mëvonshme u zgjeruar me staf akademik të kualifikuar dhe me programe të reja duke u shndërruar në Fakultetin e Ekonomisë që aktualisht ka një staf akademik prej 33 anëtarësh PAE dhe 13 antarësh PAK. Në strukturën e Fakultetit të Ekonomisë përfshihen tre Departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit ➤ Departamenti i Ekonomiksit ➤ Departamenti i Biznesit <p>Bazuar në ecurinë gjatë këtyre viteve Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore e programit plotëson të gjitha standardet lidhur me kapacitetet mësimore shkencore dhe akademike për të qënë njësi kryesore e ofrimit të programeve mësimore të suksesshme.</p>

	<p>Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit i krijuar në 16.09.2008 është njësi bazë mësimore–kërkimore e programit që përfshin fushën e kërkimit në Financë dhe Kontabilitet duke përfshirë këto disiplina përkatëse.</p> <p>Parë në tërësi, mund të themi se kemi zbatim hierarkik të strukturës në Institucion dhe asaj të Fakultetit dhe Departamentit me organe të përcaktuara qartë që mbulojnë fushën e kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe atë administrative. Në të gjitha nivelet përkatëse kemi organet e zgjedhura të cilat e bazojnë operimin dhe kompetencën e tyre bazuar në rregulloret përkatëse.</p> <p>Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit që është dhe përgjegjës për këtë program studimi në vitin aktual akademik 2019-2020 ka në përbërjen e tij 16 anëtare nga të cilët 10 PAE (nga 7 anëtarë që është kriteri minimal) dhe 5 PAK si dhe 1 staf ndihmës. Niveli i kualifikimit të PAE përbehet nga 7 anëtarë që janë me tituj/grada, 1 Profesor i Asocuar dhe 6 Doktorë, ndërsa 3 anëtarë janë me Master Shkencor. Niveli i kualifikimit të stafit PAK përbehet nga 2 Prof As. 1 Dr dhe 2 Msc. Në përbërjen e këtij Departamenti funksionojnë dy Grupe Mësimore Shkencore të ndara përkatësisht sipas dy drejtimeve prioritare të studimit; Financë dhe Kontabilitet.</p> <p>Personeli akademik që mbulon programin Bachelor në “Financë” ka pësuar ndryshime gjatë viteve të fundit rrjedhojë kjo e ndryshimeve të bëra në program në përputhje me plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi. Aktualisht stafi akademik që mbulon këtë program përfshin 29 anëtarë që janë të gjithë PAE me kualifikim përkatësisht; 1 Prof.Dr.; 5 Prof.As.; 15 Dr dhe 8 Msc. <i>(Anekset në fund të RVB, Tabelat 1.1, 2.1, 6.1)</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është relativisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për këtë program studimi që është Fakulteti i Ekonomisë si një ndër Fakultetet e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë. Në këtë njësi kryesore zhvillohen programe në fushën e ekonomisë me drejtime me specifike siç janë financat, kontabiliteti, turizmi etj. <i>(Aneksi nr. 1.4)</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është plotësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi që është Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit që mbulon këtë program i cili që në emërtim është i njëjtë me objektivin e këtij programi. Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit është njësi bazë përgjegjëse, misioni i të cilit përputhet plotësisht me programin jo vetëm në emërtim por para</p>

evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	së gjithash në kualifikimin e stafit në fushën e financës dhe kontabilitetit drejtime këto të lidhura ngushtësisht me njëra tjetrën. (Aneksat në fund të RVB)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, ka një strukturë akademike hierarkike me organin më të lartë vendimmarrës Senatën dhe deri të njëjta bazë që është Departamenti. Gjithë procesi i hartimit, axhustimit, miratimit dhe mbikëqyrjes së programit të studimit bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe kuadrin rregullues të Institucionit. Ky kuadër rregullues në nivel Institucioni përfshin Statutin, Rregulloren e Universitetit dhe udhëzimet përkatëse, ndërsa në nivel të njësisë kryesore dhe asaj baze janë rregulloret përkatëse të këtyre njërive.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe veprimtaritë kërkimore shkencore sipas fushave që ofron kjo njësi. Organet dhe autoritetet drejtuese të Fakultetit të Ekonomisë janë: Dekani, Zëvendës dekanët, Qendra Kërkimore Shkencore, Departamentet. Fakulteti organizohet në tre njësi bazë që janë Departamentet nga të cilat Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit është njësi bazë mësimore-shkencore, që përfshin fushën e kërkimit në financë, kontabilitet duke përfshirë këto disiplina përkatëse dhe njëkohësisht njësi përgjegjëse që realizon këtë program. Struktura, funksionimi, drejtimi, përbërja dhe detyrat janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit si dhe në rregulloren e këtij Departamenti.</p> <p>Parë në tërësi, mund të themi se kemi zbatim hierarkik të strukturës Universitare dhe asaj të Fakultetit dhe Departamentit me organe të përcaktuara qartë që mbulojnë fushën e kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe atë administrative. Në të gjitha nivelet përkatëse kemi organet e zgjedhura të cilat e bazojnë operimin dhe kompetencën e tyre bazuar në rregulloret përkatëse.</p> <p>GVJ verifikoi praktiken e ndryshimeve në këtë program që është realizuar gjatë viteve të fundit dhe evidentoi procesin e inicimit dhe</p>

	<p>hartimit të ndryshimeve përkatëse nga Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit dhe kalimi për miratim në instancat me të larta përkatësisht Fakultetit të Ekonomisë dhe deri tek Senati i Universitetit. Po ashtu evidentuam procesin e analizës mësimore dhe shkencore e realizuar në Departament dhe e miratuar nga organet më të larta të institucionit dhe e përfshirë në analizën e këtij institucioni.</p> <p><i>(Aneksi nr. 1.3, 1.7; Evidencat C, H, I dhe J)</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Universiteti ndjek një strategji të hapur për bashkëpunim dhe partneritet në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar për realizimin e misionit dhe të qëllimit të tij. Me institucionet e huaja arsimore që ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, institucioni ndjek një politikë favorizuese për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve, për organizimin e përbashkët të konferencave ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta kërkimore dhe trajnime profesionale.</p> <p>Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, ka miratuar që në dt. 5.12.2016 “Strategjinë e Ndërkombëtarizimit” ku janë përcaktuar drejtimit kryesore të punës për të rritur bashkëpunimin me institucione homologe. Gjithashtu në mbështetje të institucionalizimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në datë 16.05.2019 institucioni ka miratuar edhe “Rregulloren e implementimit të marrëveshjeve institucionale në kuadër të programit ERASMUS +”.</p> <p>Nga shqyrtimi i RVB dhe Raporteve Vjetore të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, evidentohet bashkëpunim i frytshëm me institucione homologe rajonale, europiane dhe më gjërë.</p> <p>Universiteti ka lidhur marrëveshje dypalëshe me Universitete të ndryshme si Universiteti i Leçes, Barit, Mesines, Perugias, Kozencës (Itali), Liezhit (Belgjike), Kretës (Greqi), Universiteti i Talin (Estoni), Universiteti i Turku-t (Finlandë) Universiteti i Vigo-s, Valencia -s (Spanjë), Universiteti i Nish- it (Serbi), Universiteti i Shkencave Natyrore Sofje (Bullgari), Universiteti i Timisoharës (Rumani), Universiteti i Alesundit (Norvegji) etj. Nëpërmjet marrëveshjeve të lartpërmendura, Universiteti ka mundur shkëmbimin e pedagogeve të cilët kanë kryer vizita afatshkurtra apo semestrare në njërin nga universitetet partnere.</p> <p>Universiteti, prej një periudhe 5-vjeçare i jep mundësinë studentëve dhe stafit akademik të marrin pjesë në programet e shkëmbimit në kuadrin e Marrëveshjeve Dypalëshe, Programit të Shkëmbimit Mevlana dhe Programit të Shkëmbimit Erasmus+.</p> <p>Universiteti, Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit ka bashkëpunim me sipërmarrje lokale, rajonale dhe institucione publike lidhur me mundësinë e punësimit të studentëve që mbarojnë studimet.</p> <p><i>Megjithatë mungesa e përfshirjes së praktikës profesionale në</i></p>

	<p><i>programin e studimit Bachelor në "Financë" do ta bënte me efektive këtë bashkëpunim në funksion edhe të punësimit të studenteve të këtij programi.</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 1.3, 1.7; Evidencat C, H, I dhe J)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ evidenton që Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit në raportet e analizave vjetore që harton (që nga viti akademik 2016 e këtej) përfshin përfitimet e personelit akademik dhe studentëve gjatë realizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtar dhe ata kombëtar. Analiza e bërë përfshin kryesisht përfitimet e vizitave të stafit në kuadër të këtyre marrëveshjeve apo projekteve të përbashkëta (ERASMUS, ERASMUE + etj. Gjithashtu evidentuam edhe mobilitetet që kanë përfituar studentët e këtij programi. Gjatë 4 viteve të fundit janë realizuar 4 mobilitete të studentëve të programit pranë Universiteteve homologe partnere në programin ERASMUS.</p> <p><i>Mendojmë që pedagogoet ashtu dhe për studentët që realizojnë këto mobilitete në kthim të përgatitin një informacion për Departamentin ku të evidentojnë eksperiencat dhe përfitimet gjatë qëndrimit në këto Universitete homologe.</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 1.3, 1.7; Evidencat C, I dhe J)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Institucioni dhe Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit kanë marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje private dhe institucione publike në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave në tregun e punës. <i>Por në kushte kur në këtë program mungon komponenti i praktikës profesionale këto marrëdhënie nuk mund të jenë të frytshme, me interes reciprok dhe të qëndrueshme.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Institucioni në statutin e tij parashikon trajnime profesionale të mëtejshme për studentet e diplomuar në bashkëpunim me punëdhënësit. Në funksion të realizimit të këtij komponenti (formimit të vazhduar) ofrohet edhe infrastruktura e nevojshme. <i>Megjithë përpjekjet e institucionit në realizimin e këtij komponenti kryesisht nëpërmjet platformave apo organizimin e takimeve të përbashkëta ky proces ende është i pa konsoliduar.</i> Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit është gjithashtu në proces studimi tregu për ofrimin e programeve të studimit të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.</p> <p><i>Mendojmë që ky komponent duhet të gjejë zbatim sa më shpejt tashmë kur jo vetëm është arritur eksperiencia e stafit por edhe është bërë domosdoshmëri plotësimi me njohuri bashkëkohore të brezave të ish studentëve të financës të viteve më të hershme.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Financë” zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe VKM nr.128 datë 17.02.2010. Ky program realizohet me kohë të plotë.</p> <p>Studimet organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Numri i moduleve që përmban programi është 28, ndërsa sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek programin Bachelor në “Financë” me kohë të plotë është 60 kredite dhe për të tre vitet e zhvillimit të tij janë 180 kredite.</p> <p>Duke shqyrtuar planin mësimor vëmë re që numri i krediteve për të gjitha nga 28 lëndët e përfshira në program janë vlerësuar me kredite që varjon nga 4 kredite deri në 7 kredite gjë që reflekton ngarkesën në auditor dhe jashtë tij si kriter bazë për përcaktimin e tyre.</p> <p><i>(Aneksi nr. 1.4)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Në funksion të strategjisë së institucionit, programi Bachelor në “Financë” synon përgatitjen e studentëve me njohuritë teorike, profesionale dhe shkencore në fushën e financave publike e private, si dhe të industrisë bankare dhe financiare.</p> <p>Në funksion të këtij synimi programi pajis studentët me njohuri bazë kryesisht në fushën e financës dhe kontabilitetit. Në të njëjtën kohë programi pajis studentët edhe me njohuri të menaxhimit dhe marketingut, të gjitha këto në funksion të tregut të punës.</p> <p>Përfundimi i këtij programi i pajis studentët me një bazë të shëndoshë të njohurive teorike shkencore dhe deri diku praktike me mundësinë për të vazhduar studimet në ciklin e dytë në programin Master.</p> <p><i>(Aneksi nr. 1.4)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe</p>	<p>Në këtë program arrihet që në lëndët e formimit bazë dhe deri diku ato karakterizuese të jepen njohuritë teorike, mbizotëruese dhe bashkëkohore lidhur me fushën e financës, institucioneve financiare dhe politikës monetare , drejtimin financiar, sistemit fiskal etj.</p>

parimeve akademike të fushës.	<i>(Aneksi nr. 1.4)</i>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p><i>Bazuar në RVB, dokumentacionin e dosjes si dhe në takimin me stafin e këtij programi studimi, mendojmë se ai arrin të zhvillojë dhe trajtojë njohuritë bashkëkohore në fushën e ekonomisë në përgjithësi dhe sidomos atë të financës në veçanti.</i></p> <p><i>Mbështetur në RVB dhe programin mësimor mendojmë që për të plotësuar me mire njohuritë e marra nga studentët në kuadër të hapësirës ligjore që IAL ka për ndryshime, GVJ rekomandon që:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>Në program të përfshihet praktika profesionale në semestrin e gjashtë para diplomimit për një periudhë jo më pak se 4 javë. Mësimi në këtë semestër mund të realizohet në këtë periudhë duke rritur ngarkesën javore.</i> ➤ <i>Në program lëndët “Marketingu Strategjik” (njohuritë bazë mbi marketingun studentit i merr që në lëndën “Bazat e Marketingut”) dhe “Sjellje Organizative” që janë të detyrueshme por që nuk janë karakterizuese mund të kalojnë me zgjedhje. Nga ana tjetër, lëndët “Legjislacioni Tregtar dhe Auditim” që në program janë me zgjedhje, mund të zhvillohen të detyruara .</i> ➤ <i>Lënda “Teknika Bankare” që zhvillohet në semestrin e I-rë të Vitit të II-të duhet të zhvillohet në kohë, pas lëndës “Institucionet Financiare”, pasi studentit në fillim merr njohuri për institucionet dhe më pas kalon në marrjen e njohurive teknike që zhvillohen në këtë lëndë.</i> ➤ <i>Programi mund të lehtësohet nga lëndë që janë të karakterit teorik shkencor dhe që mund të zhvillohen në programin e ciklit të dytë të studimeve, të tilla lënda si “Vendimet Financiare të Korporatave” apo deri diku edhe lënda e “Ekonometrisë”, mund të zëvendësohen me lëndë karakterizuese dhe praktike.</i> <p><i>(Aneksi nr. 1.4; Tabela nr.9 Aneksat e RVB)</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i programit Bachelor në “Financë” shohim se ai i përmban të gjithë elementet që përbëjnë strukturën e tij të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative në fuqi të tilla si , kohëzgjatja, numri i krediteve, ngarkesa në auditor dhe jashtë tij, sistemin e vlerësimit etj. Forma e zhvillimit të mësimin është e ndare në leksione ,seminare, punë laboratorike. Gjithashtu nga verifikimi i syllabuseve të moduleve përkatëse shohim se ato janë hartuar konform kërkesave të VKM nr.41. datë 24.01.2018.</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 1.4; Tabela nr.9 Aneksat e RVB)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas</p>	<p><i>Programi studimor ofrohet me 180 ETCS (ku përfshihen 28 module dhe detyrimet përmblyëse) me kohëzgjatje 3 vite akademike. Bazuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018 sipas kategorizimit të lëndëve të</i></p>




kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	paraqitura në programin e studimit rezulton: Lëndët bazë kategoria A përfshin 32 kredite apo 17% të numrit të krediteve ndaj 15%-20% që përcaktohet në këtë vendim. Ndërsa lëndët e kategorive B dhe C zënë secila respektivisht 99 kredite apo 55 % të numrit të krediteve (vendimi e përcakton 50% deri 55 %) dhe 25 kredite apo 14% të numrit të krediteve (vendimi e përcakton 12% deri 15%). Kategoria D përfshin 18 kredite apo 10 % të numrit të krediteve (vendimi e përcakton 10%-15 %) dhe kategoria E përfshin 6 kredite apo 3.3% (vendimi e përcakton 3% deri 5 %). (Aneksi nr. 1.4; Tabela nr.9 Anekset e RVB)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore e këtij programi përmbush kriteret ligjore për vlerësim dhe akreditim. Në këtë njësi operojnë tre Departamente të cilat ofrojnë 16 programe të ciklit të parë Bachelor dhe ciklit të dytë Master. Fakulteti i Ekonomisë për vitin akademik 2019-2020 ka një personel akademik efektiv prej 33 anëtarësh dhe PAK prej 13 anëtarësh. Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit si njësi bazë që mbulon zhvillimin e këtij programi përmbush kriteret ligjore dhe ato nënligjore në fuqi. Departamenti ka PAE prej 10 anëtarësh dhe PAK prej 5 anëtarësh. Departamenti plotëson kriteret ligjore dhe nënligjore edhe atë të kualifikimit që lidhet me zotërimin e titujve dhe gradave shkencore. Këto dy njësi janë konsoliduar gjatë 10 viteve të fundit sidomos në rritjen e kualifikimit mësimor shkencor. (Aneksi nr. 1.4; Tabela 1.1, 1.2 në fund të RVB)
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit përfshin dy GMSH përkatësisht në fushën e financës dhe kontabilitetin. Përgjegjësi i GMSH i financës është njëkohësisht personi që ka rolin e koordinorit për programin Bachelor në "Financë". Bazuar në rregulloren e programit dhe atë të Departamentit koordinatori ndjek ecurinë mësimore të programit dhe informon Departamentin në mbledhjet e analizës vjetore. Njëkohësisht koordinatori mban kontakte të vazhdueshme me studentët e programit duke përcjellë shqetësimet apo problematikën që ata referojnë lidhur me procesin mësimor. (Aneksi nr. 1.4; Tabela 1.1, 1.2 në fund të RVB)

<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore dhe Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit plotësojnë kriteret ligjore dhe rregullative lidhur me strukturën akademike numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit ekonomik. Ky Fakultet përfshin 3 departamente dhe njësi të tjera në shërbim të procesit mësimor (sekretaria mësimore). Stafi akademik i Fakultetit të Ekonomisë aktualisht është i përbërë prej 33 PAE nga të cilët 1 zotëron titullin akademik Prof.Dr; 7 zotërojnë titullin akademik Prof.Asocuar; 20 zotërojnë gradën Doktor, 1 Doktor në proces dhe 4 kanë diplomën Msc.</p> <p>Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit është i organizuar në dy GMSH me nga 5 anëtare secili. Përgjegjësi i Departamentit dhe dy përgjegjësit e GMSH kanë detyra të përcaktuara në rregulloren përkatëse të Departamentit.</p> <p><i>(Aneksi nr. 1.4; Tabela 1.1, 1.2 në fund të RVB)</i></p>		
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit plotëson kriteret ligjore për të qene i tille. Numri i PAE i këtij departamenti është 10 anëtare plus sekretaren e Departamentit (7 anëtare është kriteri ligjor) nga të cilët 1 zotëron titullin Prof. As; 6 zotërojnë gradën Doktorë dhe 3 kane diplomën Msc.</p> <p>Për realizimin e procesit mësimor të programeve që është përgjegjës, Departamenti angazhon edhe 5 PAK nga të cilët 2 zotërojnë titullin akademik Prof.As, 1 zotëron gradën Doktor dhe 2 zotërojnë diplomën e nivelit Msc.</p> <p><i>(Aneksi nr. 1.4; Tabela 1.1, 1.2 në fund të RVB)</i></p>		
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Shih vlerësimin e kriterit 3.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.3 Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar për akreditimin e programit, nga shqyrtimi i dokumentacionit të prezantuar nga Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit dhe nga verifikimi në vënd gjatë vizitës në institucion rezulton se njësia bazë disponon informacionin e nevojshëm mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky informacion është i depozituar në Departament, në</p>

	<p>pjesën me të madhe të tij është edhe në ëëbin e institucionin si një informacion i vlefshëm për studentët dhe me gjere.</p> <p><i>(Aneksi nr. 1.4)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Ky program studimor përmban të gjithë elementet e përcaktuar në Ligjin nr.80 date 22.07.2015 “Për arsimin e Larte dhe Kërkimin Shkencor në IAL” si dhe Vendimin e KM nr.41 date 24.01.2018 duke përjashtuar komponentin e praktikës profesionale të evidentuar më lart në këtë raport.</p> <p><i>(Aneksi nr. 1.4)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit ofron për studentët këtë program studimi Bachelor me 28 lëndë ku në fund studentët pajisen me titullin Bachelor në “Financë”. Programi përcakton kredite për çdo modul bazuar në ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Programi ka 180 ECTS, në përputhje me planin mësimor të propozuar nga Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit. ➤ 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve. ➤ 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit. ➤ 1 orë mësimore = 60 minuta. ➤ Një vit akademik ka 60 ECTS. <p>Provimet përgjithësisht mbahen në formë të shkruar. Megjithatë, pedagogu i lëndës mund të vendosë për të kryer provimin në formën e një provimi me gojë, projekt ose detyrë kursi.</p> <p>Vlerësimi i studentëve në programin Bsc “Financë” bëhet në bazë të sistemit me 10 nota që i referohen diapazonit të pikëve përkatëse, të krediteve dhe ECTS-ve, e llogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar në rregulloren përkatëse.</p> <p><i>(Aneksi nr.1.4; Tabela 11 në fund të RVB)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të këtij programi studimi shohim se ai jep informacionet për të gjithë elementet përfshirës në një program studimi të nivelit të pare. Në varësi të lëndës në program është përcaktuar ngarkesa mësimore totale në ore të ndara në auditor dhe jashtë tij. Studenti realizon çdo vit jo më pak se 1500 orë punë brenda dhe jashtë auditorit. Ngarkesa mësimore në auditor është e ndarë në orë leksioni dhe orë seminari.</p> <p>Në funksion të këtij treguesi janë të përcaktuara dhe numri i ECTS-ve.</p> <p>Lëndët në planin mësimor krahas vendosjes sipas semestrave dhe viteve përkatëse, janë njëkohësisht edhe të grupuara sipas natyrës së tyre dhe të kodifikuara.</p> <p>Mësimi në këtë program është me kohë të plotë gjatë 5 ditëve të javës. Bazuar në syllabuset e lëndëve përkatëse forma e kontrollit të dijeve është e vazhdueshme nëpërmjet vlerësimeve gjatë zhvillimit</p>

	<p>të seminarit dhe testimi të ndërmjetëm si dhe vlerësimi në provimin përfundimtar. Raporti i vlerësimit të gjithë elementëve gjatë vitit me atë përfundimtar është kryesisht 40% me 60 %, por në lëndë të caktuara raporti është me i theksuar në favor të vlerësimit përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e ofruar nga njësi kryesore/baze si dhe nga takimi me studentët e programit, GVJ evidenton se institucioni jep informacionin e nevojshëm që në momentin e mundësisë për të ndjekur këtë program studimi dhe deri në përfundim të tij. Gjatë periudhës para dhe gjatë realizimit të studimit studentët marrin informacion mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Rregullores së studimeve të institucionit. ➤ Rregullores së Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit ➤ Rregullores së Programit Bachelor në “Financë” ➤ Informacionit të dhënë nga koordinatori i programit. <p>(Aneksi nr. 1.3, 1.4, 2.1)</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit rezulton se ai përfshin gjithë elementet përbërës formues teorike e praktik për një program të nivelit Bachelor në “Financë”. Syllabuset e lëndëve përkatëse përmbajnë të gjithë elementet e përcaktuara në Vendimin e KM nr.41 datë 24.01.2018 si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Emërtimi i lëndës/modulit ➤ Ngarkesa Lex/sem ➤ Viti/semestri kur zhvillohet lënda ➤ Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën ➤ Vendi që zë lënda apo tipologjia në formimin tërësor të studentit dhe kodi i saj ➤ Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentin për përvetimin e lëndës ➤ Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë ➤ Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik ➤ Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS ➤ Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre ➤ Format e vlerësimit të studentëve që përfshijnë atë periodik dhe në fund të semestrit ➤ Detyrimet e studentit për lëndën lidhur me frekuentimin ➤ Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse <p>Nga takimi me stafin e Departamentit, GVJ evidentoi ushtrimin e të</p>




	drejtës se lirisë akademike në realizimin e programit të përcaktuar paraprakisht. (Aneksi nr. 1.3, 1.4, 2.1)			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Gjatë 4-5 viteve të fundit programi ka pësuar disa ndryshime të cilat kanë konsistuar në futjen e lëndëve të reja duke zëvendësuar lëndë të trajtuara më parë. Në fillim të vitit akademik stafi përgatit syllabuset për lëndët që mbulojnë të cilat miratohen nga titullari i Departamentit. <i>Megjithëse rregullorja e institucionit nuk e përcakton nënshkrimin nga Përgjegjësi i Departamentit të syllabusve, sugjerojmë që kjo të bëhet e detyrueshme duke eliminuar kështu një numër syllabusesh që nuk e kanë këtë nënshkrim. Gjithashtu edhe literatura e huaj për një numër lëndësh nuk ka të përcaktuar periudhën e botimit ose kjo e fundit është relativisht e hershme.</i> (Aneksi nr. 1.4, 1.5)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ky program studimi plotëson kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ai realizohet me një ngarkese mësimore, shkencore dhe praktike me 180 ECTS dhe me afat kohor tre vite akademik. Gjithashtu edhe struktura e programit është konform kriterëve ligjore dhe nënligjore. (Aneksi nr. 1.4)
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Programi në përmbajtjen e tij është në përputhje me emërtimin e tij. Ai ka tiparet e një programi të nivelit Bachelor në fushën e financës. Lëndët formuese në këtë program fokusohen në fushën e financës dhe trajtojnë jo vetëm aspektin teorik të njohurive financiare por edhe trajtimin sa më afër realitetit të kësaj fushe. Gjithashtu edhe struktura e grup lëndëve është në përputhje me kriteret ligjore dhe nënligjore në fuqi. <i>Mangësi në këtë strukturë është mungesa e praktikës profesionale e cila do të mund të jepte më shumë mundësi studentëve që përfundojnë këtë program të punësohen në sektorin privat dhe publik në profesionin e financiarit.</i> (Aneksi nr. 1.4, 1.5)

<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Programi Bachelor në “Financë” arrin të pajisë studentët krahas njohurive të përgjithshme të ekonomisë, por para së gjithash njohuri specifike të financës, menaxhimit financiar, politikës fiskale dhe monetare etj. Programi synon deri diku që nëpërmjet trajtimeve në laborator apo raste studimore nga sektori financiar të rrisë edhe njohuritë praktike që përfshijnë fushën e financave.</p> <p>Mbështetur në 28 lëndët që ofron programi ai arrin të ketë objektiv formimin teorike shkencor dhe relativisht edhe atë praktik të studentëve. Në këtë kuadër futja e praktikës profesionale do i shërbejë objektivit të aftësimin profesional të studentëve.</p> <p><i>(Aneksi nr. 1.4)</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore europiane dhe të vendit, duke vlerësuar nevojat e tregut të punës.</p> <p>Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me profilin e zgjedhur që është fusha e financës. Bazuar në eksperiencën e zhvillimit të programeve në këtë profil në universitetet homologe brenda dhe jashtë vendit në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimin e studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë .</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Bazuar në kriteret e përcaktuara është bërë kategorizimi i lëndëve që zhvillohen në këtë program sipas veprimtarisë formuese. Ky kategorizim ka respektuar strukturën e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore.</p> <p>Programi në përgjithësi arrin tu japë studentëve njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike dhe që mund të plotësojë dy drejtimit e mundshme të tyre pas përfundimit të tij:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Mundësinë e vazhdimin të programit të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional dhe Master i Shkencave. Këtë e bazojmë në lëndët që zhvillohen në të cilat arrihet të merren njohuritë teorike shkencore të nevojshme para se të kalohet në studimet e ciklit të dytë. ➤ Mundësinë e punësimin pas përfundimit të këtij programi në pozicionin e arkëtarit apo financiarit në sektorin privat apo atë financiar. <p>Programi i studimit arrin që të realizojë transferim të studimeve në institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe të japë mundësi mobiliteti për studentët pranë universiteteve të huaja në kuadër të programeve ERASMUS ku është i përfshire institucioni.</p> <p><i>(Aneksi nr. 1.4, 1.5)</i></p>




<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Krahas plotësimit të kriterëve të hartimit të syllabuseve të lëndëve/moduleve të këtij programi lidhur me elementët e nevojshëm në to, GVJ verifikoi që në Departamentin e Financës dhe Kontabilitetit janë miratuar ndryshime me qëllim të përmirësimit të përmbajtjes së tyre. Pozitiv është fakti që me propozimin e Departamenteve të Fakultetit të Ekonomisë është miratuar me vendim nr.prot. 178 datë 21.10 2019 literatura e miratuar në këtë Fakultet.</p> <p><i>Megjithatë në një numër të syllabuseve literatura ndihmëse në gjuhë të huaj ose i referohet botimeve më të hershme ose nuk jep vitin e botimit të teksti përkatës. Gjithashtu, një pjesë e kësaj literature të huaj nuk bënte pjesë në fondin e Bibliotekës së institucionit.</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 1.5)</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Finance” i pajis studentët me njohuri bazë teorike shkencore dhe deri diku praktike të fushës së financës duke përmbushur kështu objektivat, synimet dhe fizionominë e një programi studimi të ciklit të parë. Në tërësinë e tij programi bazohet në një harmonizim në strukturë të grup lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese.</p> <p><i>Në kuadër të plotësimit më mirë të objektivave dhe synimeve të programit njësia kryesore dhe bazë mund të lehtësonte (çlironte) grupin e lëndëve karakterizuese nga lëndët “Ekonometri”, “Menaxhim Biznesi” dhe “Mikroekonomia” dhe të mund ti zëvendësonte ato me lëndë të profilit të financës qoftë edhe nëpërmjet riklasifikimit të lëndëve në program apo dhe zëvendësimin e tyre brenda hapësirës ligjore të ndryshimit deri në 20 %.</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 1.4, 1.5)</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit u mundëson plotësisht studentëve që diplomohen për të kaluar në programin e ciklit të dytë të studimit Master Profesional ose Master Shkencor,</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion evidentoi që gjatë 4-5 viteve të fundit një pjesë e konsiderueshme e studentëve që kishin përfunduar këtë program ishin regjistruar dhe kishin ndjekur/përfunduar programet e studimit të ciklit të dytë në nivel Master Profesional apo Master Shkencore pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.</p> <p><i>(Aneksi nr. 1.4, 1.5)</i></p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve</p>	<p>Krahas plotësimit të kriterëve të hartimit të syllabuseve të lëndëve/moduleve të këtij programi lidhur me elementët e nevojshëm në to, GVJ konstatoi që në Departamentin e Financës dhe Kontabilitetit janë miratuar ndryshime me qëllim të përmirësimit të përmbajtjes së tyre. Në funksion të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore si dhe në përshtatje të kërkesave të tregut të</p>

nga tregu i punës.	punës me propozim të Departamentit gjatë viteve të fundit janë miratuar në Senatën e Universitetit (Vendimi nr.58 date 6.09.2018) ndryshime në kurrikulen e programit të studimit në “Financë” deri në kufirin 20%. Gjithashtu janë miratuar edhe ndryshime në numrin e krediteve të lëndëve të veçanta në këtë program. (Aneksi nr. 1.4, 1.5)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi për vitin akademik 2019-2020 përbëhet nga 29 Personel Akademik Efektiv dhe asnjë Personel Akademik me Kontratë. Në këtë program janë të angazhuar i gjithë stafi i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit që mbulon lëndët e profilit të financës dhe staf nga departamentet e tjera të njësisë kryesore dhe Fakulteteve të tjera të Universitetit në funksion kjo të objektit të moduleve. Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në kontratën e punës dhe në rregulloren e personelit. Personeli akademik i programit është i angazhuar në mësimdhënie dhe kërkim shkencor sipas kërkesave dhe standardeve të institucionit. Personeli akademik i programit plotëson kërkesat ligjore dhe kuadrin rregullativ në fuqi e realizuar sipas procedurave standarde të rekrutimit. (Tabela 1.1; 1.2; 2.1; 4; 7 dhe 8 në fund të RVB)
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Nga verifikimi i dokumenteve që kërkua gjatë vizitës në institucion rezulton se të gjithë titullarët e lëndëve të angazhuar në zhvillimin e këtij programi studimi kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për të zhvilluar me sukses procesin mësimor në këtë program. Për vitin akademik aktual, stafi akademik që mbulon këtë program është i përbërë nga 29 anëtarë të gjithë me kohe të plote nga të cilët 10 anëtarë janë të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit dhe 19 anëtarë janë nga Departamente të tjera të njësisë kryesore /bazë të Universitetit. Stafi i programit përmbush kriteret e kualifikimit akademik ku përfshihen 1 anëtar me titullin akademik Prof.Dr, 4 anëtarë me titullin akademik Prof.As, 16 anëtarë me gradën Doktor dhe 8 anëtarë me diplomë Msc. Shihet që në total pedagogët pa grada shkencore dhe tituj akademik

	<p>zenë rreth 27 % të personelit të angazhuar në këtë program. Duke filluar nga viti akademik 2018-2019 e në vazhdim i gjithë programi zhvillohet nga personel akademik me kohë të plotë.</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit mban titullin akademik Prof.As.</p> <p><i>(Tabela 1.1; 1.2; 2.1;.4; 7 dhe 8 në fund të RVB)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Krahas plotësimit të kualifikimit akademik dhe shkencor personeli i angazhuar në këtë program është i kualifikuar në përputhje me objektin apo fokusin e modulit që zhvillon në program. Kualifikimet e stafit dhe eksperiencia e tyre përputhen me profilin e programit. GVJ konstatoi nga informacioni i marre në Zyrën e Burimeve Njerëzore të institucionit, dhe CV-të e personelit akademik të programit që titullarët e lëndëve që përmban programi kanë eksperiencë në mësimdhënien e lëndëve që ata mbulojnë në këtë program.</p> <p><i>(Tabela . 1.1; 1.2; 2.1;.4; 7 dhe 8 në fund të RVB)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ evidentoi gjate vizitës në institucion se personeli akademik angazhohet në mbështetjen e atyre studentëve që mbrojtjen e diplomës e realizojnë me punim diplome (ata studentë që plotësojnë kriterin e notës mesatare) duke i angazhuar në tema të lidhura me praktiken pranë sektorit privat, publik apo institucionet financiare .</p> <p><i>Në këtë program nuk përfshihet praktika profesionale e cila do të ishte edhe një urë lidhëse mes diplomimit dhe tregut të punës .</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në strukturën e personelit të institucionit/njesisë kryesore apo bazë janë të emëruar edhe personeli ndihmës mësimor shkencor pranë tyre dhe laboratorëve apo shërbime të tjera në funksion të procesit mësimor. Nga vizita në institucion ky personel ndihmës mësimor që shërbente pranë laboratorit të Informatikës ofronte ndihmën gjatë zhvillimit të mësimit praktik për tema të caktuara në lëndët e programit si Kontabilitet, Ekonometri etj, apo pranë Bibliotekës për ofrimin e literaturës së nevojshme për studentët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL-it dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ evidentoi që institucioni me vendimin nr.1 datë 13.01.2020 ka miratuar udhëzuesit mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Ky dokument vjen në këtë kohë kur niveli i mësimdhënies ballafaqohet me kërkesa shtesë që kanë në thelb rritjen cilësore dhe inovative të procesit të mësimdhënies. Megjithatë e rëndësishme është që ky dokument i miratuar së fundmi të nxisë personelin akademik që të verë në zbatim drejtimet e përcaktuara në të.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, ka përmirësuar kuadrin monitorues, mbikëqyrës dhe vlerësues të stafit akademik në përputhje me ndryshimet ligjore dhe nënligjore, (Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”). Këtij qëllimi i kanë shërbyer një numër vendimesh të Senatit të marra gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019. Këto vendime përfshijnë përcaktimin e formularit të vlerësimit të performances, procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve, përcaktimi i kriterëve për matjen e performancës së stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, etj.</p> <p>Bazuar në organigramën dhe strukturën e institucionit si dhe në takimet e realizuara, monitorimi dhe vlerësimi periodik i performancës të stafit akademik dhe ndihmës të programit realizohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Në nivel institucional nga Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve, e krijuar me vendimin e Senatit të Universitetit në datë 20.08.2019 ish Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit. Kjo drejtori ka dy nënstruktura, Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSBCVI) dhe Sektorin e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Në nivel institucional në funksion të këtij qëllimi operon dhe Komisioni i Përhershëm i ngritur me vendim Senati. ➤ Në nivel të Njesisë Kryesore nga Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit që mbulon programin. <p>Këto dy struktura përgjegjëse monitorojnë dhe vlerësojnë periodikisht mësimdhënien nëpërmjet performancës akademike që kryen Departamenti si dhe anketimeve me studentët e programit në</p>

	<p>fund të çdo semestri mësimor. Ky vlerësim paraqitet në formën e një raporti të veçante dhe u paraqitet instancave përkatëse për analizë të mëtejshme dhe miratim. Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies e prezanton nëpërmjet raporteve periodike pranë instancave vendimmarrëse përkatëse më të larta si dhe pranë Departamentit. GVJ evidentoi dhe shqyrtoi raporte të strukturave përkatëse lidhur me vlerësimin e performancës së stafit akademik.</p> <p><i>(Aneksi nr. 3.1, 3.2, 3.3, 3.4)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në funksion të vlerësimit të mësimdhënies institucioni përfshin edhe studentët e programit. Vlerësimi i studentëve për cilësinë e mësimdhënies realizohet në dy metoda;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Metoda të tërthorta kryesisht në formën e anketimeve me studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Ky anketim zhvillohet dy herë në vit në fund të çdo semestri para se të zhvillohet provimi përfundimtar. Pyetësi që përdoret në këtë formë vlerësimi është miratuar me vendim Senati dhe është anonim. Rezultatet e anketimit i bëhen të ditura stafit për të përmirësuar punën në të ardhmen. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të Institucionit, atyre të Fakulteteve dhe Departamenteve ku edhe analizohen si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. ➤ Metodë e drejtpërdrejtë e cila realizohet nëpërmjet takimeve dhe diskutimeve të koordinatorit të programit, pedagogut të lëndës dhe studentëve për të tërhequr opinionit e tyre lidhur me mësimdhënien. <p>Mbështetur në format e ndryshme që aplikohen lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik plotësohet edhe formulari i vlerësimit për çdo anëtar të stafit të programit, praktikë kjo e nisur para dy viteve.</p> <p><i>(Evidenca K dhe L)</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënien bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJBSCVI si struktura përgjegjëse për monitorimin e mësimdhënies dhe Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, përgatitin dhe shpërndajnë në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë e mësimdhënies, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese në nivel Fakulteti dhe Departamenti por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel Departamenti, Dekanati dhe Rektorati.</p> <p><i>(Aneksi nr. 3.4, 3.5; Evidenca K dhe L)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira,</p>	<p>NJBSCVI bazuar në rezultatet e anketimit dhe vlerësimin me pikë të procesit të mësimdhënies për çdo personel akademik mësimdhënës, harton një raport periodik vjetor të ecurisë së programeve të dy</p>

<p>nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>niveleve të studimit mbi problematikën e dalë. Në funksion të kësaj problematike instancat drejtuese në qendër dhe ajo e njësisë bazë mësimore shkencore, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, parashtrajnë masat që duhen ndërmarrë për përmirësimin e procesit dhe rritjen e cilësisë.</p> <p>Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit në analizën e Raporteve Vjetore të veprimtarisë mësimore shkencore evidenton performancën e anëtareve të tij lidhur me veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë shkencore (botimet, pjesëmarrje në konferenca etj). Mbështetur në vlerësimin e personelit akademik, dhe opinionit të shfaqur nga studentët, kryesisht të atyre të organizuar në “fokus grupe” dhe pyetësorët online, institucioni programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik.</p> <p>(Aneksi nr. 2.8, 3.9)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Rregullorja mësimore e institucionit, rregullorja e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit dhe rregullorja e këtij programi studimi përcaktojnë format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura; leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime pune në laborator etj, të organizuara në 28 lëndë, të cilat vlerësohen nëpërmjet testeve me shkrim dhe tema e diplomës e cila organizohet me goje/shkrim dhe mbrojtje punimi (sipas kriterit të mesatares). Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje duke ruajtur raportet mes tyre.</p> <p>Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit të çdo lënde dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit forma e kontrollit në program është kryesisht me shkrim (vetëm dy lëndë forma e vlerësimit është me goje). Në zhvillimin e provimeve nuk bëhet sekretimi apo kodifikimi i tij mangësi që duhet të rregullohet në të ardhmen. Forma e vlerësimit realizohet në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor me notë (1 deri 10) dhe ekuivalentin e notave nga F në A. Sistemi i vlerësimit është i</p>




	<p>vazhdueshëm dhe në përfundim të semestrit ndahet kryesisht në:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ 10 % apo 10 pike është vlerësimi gjatë semestrit ➤ 30 % deri 40 % ose 30-40 pike provim i ndërmjetëm që zhvillohet në mes të semestrit ➤ 50 % deri 60 % ose 50 -60 pike provimi përfundimtar që zhvillohet në fund të semestrit. <p>Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e çdo lënde.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Bazuar në takimin me stafin akademik të programit dhe grupin e studentëve, GVJ evidenton se niveli i mësimdhënies është përmirësuar si rezultat i dy faktorëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Experiencës mësimdhënëse të fituar nga një pjesë “e konsoliduar” e stafit akademik në këtë proces. ➤ Marrjes së përvojës nga personel akademik të kualifikuar që gjatë 5-6 viteve të para kanë zhvilluar disa nga lëndët formuese të këtij programi, këtu kemi parasysh angazhimin me kohë të pjesshme të pedagogëve të kualifikuar me titull akademik Prof.Dr. nga Fakulteti Ekonomik i Tiranës. <p>Në takimin me studentët GVJ evidentoi bashkëbisedimin e tyre me pedagogët e lëndëve lidhur me problematikën e rritjes së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Në kushtet kur programi nuk ka praktikë profesionale studentët kanë sugjeruar zhvillimin e temave të caktuara sa më praktike nëpërmjet punëve laboratorike gjë që është marrë në konsideratë nga stafi.</p> <p><i>Mendojmë që duke u bazuar në kualifikimet e stafit ku numri i stafit të programit me tituj akademik është i ulët (18 % e numrit total) është e rëndësishme që të intensifikohet puna e rritjes së nivelit të mësimdhënies si nëpërmjet aftësive pedagogjike ashtu edhe kërkimore shkencore. Një ndihmesë në këtë drejtim është dhe udhëzimi mbi mësimdhënien i miratuar me vendim Senati numër 1 datë 13.01.2020.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni ve në dispozicion të stafit infrastrukturën e duhur për përdorimin e metodave sa me bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor (laboratorë, bibliotekën etj).</p> <p>Mbështetje kryesore për personelin akademik do të veçonim mobilitetet që u janë ofruar disa prej anëtareve të stafit akademik përmes vizitave pranë universiteteve homologe jashtë vendit në kuadër të programit ERASMUS +. Një ndihmë tjetër ndonëse vetëm për disa prej anëtareve të stafit është dhe mbështetja financiare në disa raste për botimet në revista shkencore apo pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare.</p> <p><i>Pavarësisht nga sa me sipër mendojmë se institucioni duhet të bëjë</i></p>

	<p>të zbatueshëm udhëzimin mbi metodat e mësimdhënies qoftë edhe duke organizuar seminare me fokus rritjen e nivelit pedagogjik dhe kompetencave didaktike për stafin që kanë marrë vitet e fundit grada shkencore apo kanë përfunduar diplomimin në programin Master i Shkencave.</p> <p><i>(Aneksi nr. 2.8; Tabela 16; 17; 18; dhe 19 në fund të RVB)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ bazuar në shqyrtimin e CV-ve të personelit akademik të programit si dhe nga opinionet e marra nga takimi me studentët evidenton kompetencë të tyre në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve në procesin e mësimdhënies sipas lëndëve që ata zhvillojnë.</p> <p><i>Megjithatë bazuar në evidencën “Ngarkesa mësimore Viti Akademik 2017 -2020”, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, departamenti duhet të diskutojë dy evidentimet tona të mëposhtme:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>Së pari, një numër anëtarësh të stafit të departamentit zhvillojnë 4 lëndë dhe në disa raste 5 lëndë gjë që rrit jo vetëm ngarkesën në mësimdhënie por ka prirje të ulë zhvillimin e tyre me cilësi.</i> ➤ <i>Së dyti ngarkesa mësimore për një numër të konsiderueshëm të stafit është relativisht e lartë e cila varjon nga 420 orë mësimi në auditor deri në 480 orë. Pavarësisht se kjo argumentohet me faktin e planifikimit dhe miratimit të mbingarkesës në njësinë kryesore, mendojmë se kjo mbingarkesë ndikon në cilësinë e mësimdhënies. Argumenti i dhënë nga Departamenti se parashikohet ulje në numrin e studentëve në vitet e ardhshme nuk justifikon këtë mbingarkesë që mund të zbutet disi me angazhimin e pedagogëve të ftuar apo edhe me lehtësimin e programit me një apo dy lëndë dhe përfshirjen e praktikës profesionale.</i>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Siç e kemi theksuar edhe me lart stafi i programit ka marrë në konsideratë mendimet dhe sugjerimet e studentëve të programit për të përmirësuar procesin e mësimdhënies. Përfshirja më shumë e trajtimit të rasteve studimore apo detyrave në laborator për lëndët të Kontabilitetit apo Ekonometrisë është pjese e këtij reflektimi.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Nga takimi me studentët GVJ morri opinionin e tyre lidhur me aplikimin gjatë procesit mësimor të diskutimeve në grup dhe shkëmbimeve të mendimeve sidomos kjo gjatë zhvillimit të seminareve dhe mbrojtjes së detyrave të kursit.</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e</p>	<p>Eksperiencia në rritje e mësimdhënies së stafit të programit, marrja e eksperiencës nëpërmjet vizitave pranë universiteteve të tjera si dhe respektimi dhe rëndësia e opinionit të studentëve janë premisa që bëjnë të mundur vënien në qendër të procesit mësimor të cilësisë</p>

marrëdhëniet e respektit të ndërsjellë mes tyre.	dhe ndërtimit të marrëdhënies bashkëpunuese me studentët. (Aneksi nr. 2.9, 2.9.1)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, zotëron hapësira të mjaftueshme dhe bashkëkohore në procesin mësimor dhe shkencor nëpërmjet laboratorëve të kompletuar mirë, klasa, zyra, salla konferencash, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë. Mësimi në këtë program zhvillohet në godinën A në të cilën zhvillojnë mësim programet e Fakultetit të Ekonomisë që ofron hapësirat e mjaftueshme për zhvillimin normal të mësimt. (Tabela 16; 17; 18; dhe 19 në fund të RVB)
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Auditorët në godinën A janë të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për ushtrimin e një procesi mësimor sa më efektiv. Godina ka salla leksionesh me kapacitete relativisht të mëdha në rastet e zhvillimit të përbashkët të leksioneve për lëndë të përbashkëta të këtij programi me atë të programit Bachelor në “Kontabilitet”. GVJ vizitoi auditorët dhe laboratorët e kësaj godine dhe evidentoi pajisjen e tyre me infrastrukturën e nevojshme. Edhe në disa auditorë ku nuk ishin të instaluar vidioprojektorët pedagoget pajiseshin me të tillë para dhënies se mësimt nga Departamenti.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Personeli akademik i programit dhe studentët e tij shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike që ofron institucioni në funksion të procesit mësimor. Në ambientet e godinës A ka akses internet 3G-4G. Studentët përdorin adresat e email-eve të pedagoqeve për një komunikim të shpejtë dhe të vazhdueshëm me ta si dhe marrin nga pedagoget informacione shtesë. Nga takimi me studentët GVJ evidentoi që përmes këtij mjeti komunikimi ata caktonin edhe orë konsultimi, rezultatet dhe reklamimet e mundshme lidhur me vlerësimin e tyre etj. Në këtë godine funksionon dhe laborator i informatikës në të cilin realizohen orë të programit në lëndë të veçanta të tij.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të	GVJ shqyrtoi syllabuset e programit në funksion edhe të literaturës së rekomanduar në funksion të kësaj realizoi edhe vizitën në ambientet e Bibliotekës së institucionit. Literatura bazë dhe ajo ndihmëse në funksion të programit të studimit u ofrohet studentëve

<p>nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>në formën e teksteve mësimore bazë në Bibliotekën e universitetit. Ato gjenden në formë hard copy (3-5 kopje për çdo titull) . Tekstet bazë janë kryesisht tekste të autorëve vendas, profesorë të Fakulteteve të Ekonomisë si dhe disa tekste ndërkombëtare të përkthyer për studentët. Tekstet ndihmëse të rekomanduara (kryesisht të fushës së financës) në përgjithësi janë të autorëve të huaj të mirënjohur.</p> <p>GVJ evidentoi që tekstet e miratuara në Departament sipas listës së miratuar në njësinë kryesore përgjithësisht gjenden në Bibliotekën e institucionit. <i>Mendojmë se fondi i librave të fushës së financës në gjuhë të huaj duhet të jetë më i madh në numër.</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Bibliotekën e institucionit evidentoi fondin e librave të inventarizuara dhe konstatoi që pothuajse gjendeshin të gjitha tekstet bazë të rekomanduara në syllabuset e lëndëve të programit. Studentët gjenin në formë hard copy tekstet mësimore të autoreve shqiptarë të rekomanduara si dhe një fond librash të përkthyer apo në gjuhën kryesisht angleze.</p> <p>Gjate 2-3 viteve të fundit institucioni ka ndërmarrë iniciativa për të zhvilluar format online të shfrytëzimit të literaturës përmes shërbimit digjital, proces që kërkohet të shpejtohet tashmë kur këto forma burimi të literaturës po gjejnë më shumë zbatim nga stafi pedagogjik dhe studentët. Në Bibliotekë ishin të depozituar dhe një sërë cikle leksionesh të pedagogëve lidhur me lëndët që zhvillojnë në këtë program.</p> <p>Në Bibliotekë gjendeshin botime periodike dhe programe kompjuterike, si dhe libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, dhe studentët janë të regjistruar dhe shfrytëzojnë këto mundësi.</p> <p>Oraret e punës të Bibliotekës janë të shpallura në faqen eeb të institucionit dhe janë të shfaqura edhe në hyrje të saj, e cila është e hapur për studentët nga e Hëna deri të Shtunën.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Stafi akademik dhe studentët së fundmi kanë akses të shfrytëzojnë shërbimin e bibliotekës online "ULIBRARY". Në funksion të këtij shërbimi institucioni ka përgatitur udhëzuesin përkatës që lehtëson përdorimin e këtij shërbimi.</p> <p><i>(Tabela 16; 17; 18; në fund të RVB)</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Siç e kemi theksuar më lart nga vizita në institucion dhe takimi me stafin akademik dhe studentët, këta të fundit shfrytëzonin laboratorin e Informatikës për të zhvilluar një pjese të programit në lëndët ku mund të aplikohet trajtimi praktik në raste studimore, Kontabilitet të Aplikuar, Ekonometri etj.</p>




<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Institucioni ofron platformën elektronike UVMS e cila i jep akses personelit mësimor dhe studentëve që të marrin informacionet. Kryesisht kjo platformë përdoret me marrjen e informacionit nga studentët në site-in përkatës të pedagogut lidhur me prezantimet e leksioneve, rezultatet e testimeve dhe komunikime të tjera. <i>Ende nuk ka praktika të bashkëbisedimeve apo trajtimeve të temave të veçanta në këtë platformë mes stafit dhe studentëve.</i> (Aneksi nr. 2.8; Tabela 16; 17; 18; dhe 19 në fund të RVB)</p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Forma më kryesore e komunikimit të brendshëm është përdorimi i platformës elektronike UVMS dhe adresave personale të email-it që kanë pedagogët dhe studentët e programit. (Aneksi nr. 2.8; Tabela 16; 17; 18; dhe 19 në fund të RVB)</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Procesi i mbrojtjes së diplomës është përcaktuar në rregulloren e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit. Ky proces paraprihet nga shpallja nga Departamenti i fushave kryesore për punimet e diplomave të cilat u jepen studentëve në fund të semestrit të parë të vitit të III-të akademik. Nga takimi me studentët që plotësonin kriteret me punim diplome ata ishin informuar me këto tema orientuese diplomimi dhe ishin në fazën e aplikimit pranë Departamentit për miratimin e temës së zgjedhur dhe udhëheqësit përkatës. Për studentët e tjerë që mbrojtjen e realizojnë me provim Departamenti harton programin e provimit të formimit duke i orientuar për temat e lëndëve që përfshihen dhe literaturën përkatëse. Nga praktika e viteve akademike të kaluara GVJ pa gjithë procesin e realizimit të diplomimit të studentëve që ishte në koherent me procedurën e përcaktuar në rregulloren përkatëse.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, që nga krijimi i tij dhe aktualisht ka ngritur strukturë institucionale të veçante që ka në fokus ndjekjen dhe promovimin e përmirësimin të cilësisë. Kjo strukturë që fillimisht emërtohej Drejtoria e Edukimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional në vitin 2019 u emërtua, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve që ka në varësi NJSBCVI si njësi të fokusuar në këtë drejtim. Kjo njësi</p>

	<p>bashkëpunon dhe koordinon punën me të gjitha njësitë kryesore/bazë të institucionit dhe në këtë kontekst edhe me Departamentin e Financës dhe Kontabilitetit që mbulon këtë program.</p> <p><i>(Aneksi nr. 1; Tabela 24 në fund të RVB)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Bazuar në kuadrin ligjor, nënligjor dhe atë rregullues të institucionit, Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit janë përgjegjësit direkt lidhur me cilësinë e mësimdhënies në këtë program. Këto njësi bazuar në rregulloren e Departamentit dhe rregulloren e programit koordinojnë punën me NJSBCVI-në në rang institucional</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Analiza vjetore e punës mësimore shkencore të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit është kryesisht forma kryesore e diskutimeve lidhur me zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies. Përmes problematikës së dalë, opinioneve të studentëve dhe bashkëbisedimit në këto mbledhje arrihet në konkluzione apo iniciativa për përmirësimin e metodave të mësimdhënies.</p> <p><i>Megjithatë GVJ evidentoi nga raportet vjetore të Departamentit që ende ky proces zë peshë të vogël në këtë analizë. Udhëzimi përkatës lidhur me këtë objekt vlerësimi që se fundmi është miratuar nga Senati i Universitetit duhet të jetë promotor i zhvillimeve inovative në metodat e mësimdhënies.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik i programit gjatë 4-5 viteve të fundit ka patur progres lidhur me kualifikimin shkencor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të institucionit shihet rritja e kualifikimit shkencor në dy drejtime kryesore</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Marrja e gradës shkencore nga anëtarë të stafit akademik të cilët kane përgatitur dhe mbrojtur punimin e doktoraturës. Gjatë kësaj periudhe kanë marrë gradën shkencore “Doktor” katër anëtarë të këtij stafi duke e rritur në 16 anëtarë stafin akademik të këtij programi. ➤ Rritja e botimeve shkencore, pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, seminare, nga stafi akademik i programit. <p>Institucioni ka mbështetur financiarisht anëtarë të stafit lidhur me botimet shkencore dhe pjesëmarrjet në konferenca shkencore një praktikë kjo që duhet vlerësuar.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në kuadër të projekteve të bashkëpunimit të institucionit me Universitete homologe jashtë vendit është arritur të realizohen një numër i kufizuar mobilitetesh lidhur me vizitat të anëtarëve të stafit akademik të programit jashtë vendit, gjë që ndihmon në kualifikimin e tyre mësimor shkencor.</p> <p><i>Megjithatë, për vetë përvojën relativisht jo të gjatë mësimore të një</i></p>

	<p>numri të stafit akademik të angazhuar në këtë program, institucioni dhe njësia kryesore/bazë duhet të organizojë workshop me objekt rritjen e aftësive pedagogjike dhe didaktike për ata anëtarë të stafit akademik që sapo kanë marrë gradën Doktor, janë në proces apo kanë diploma Msc.</p> <p>(Aneksi nr. 2.8; Tabela 20 në fund të RVB)</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore si dhe në kuadrin rregullativ të brendshëm (të cituar disa herë me lart) personeli akademik merr përgjegjësitë për zbatimin e programit të studimit Bachelor në “Financë” dhe njëkohësisht ndjek dhe monitoron gjithë procesin e realizimit të tij. Nga takimi me stafin e programit evidentuam analizën serioze gjatë mbledhjeve të Departamentit me objekt veprimtarinë vjetore të tij.</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e prishmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Tashmë stafi akademik i programit prej disa vitesh në zbatim edhe të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore, por edhe si domosdoshmëri për tu përshtatur rritjes së cilësisë së mësimdhënies përdorin metodat bashkëkohore të testimit në formë dhe përmbytje. Tregues mbështetës në këte drejtim janë rezultatet e arritura të studentëve, opinion i tyre pozitiv i shprehur në menyre direkte dhe indirekte si dhe objektivi për të qënë në të ardhmen inovativ në këte proces. (Evidenca K dhe L)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit për akreditimi nga institucioni si dhe vizita në ambientet e tij evidentuam se kriteret dhe mënyrat e testimit të vlerësimit të njohurive dhe dijeve të studentëve janë të përcaktuara qartë në tre rregulloret përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Rregulloren e institucionit (rregullore e Universitetit), ➤ Rregulloren e programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Financë” e miratuar nga njësia kryesore dhe ➤ Rregulloren e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit <p>(Aneksi nr. 1.3; 2.1 dhe Evidenca C)</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve</p>	<p>Studentët në takimin që GVJ organizoi me ta konfirmuan që në fillim të semestrit ata informohen nga pedagogu i lëndës si dhe nga prezantimi i syllabusit që ai bën lidhur me metodologjinë dhe format e testimit, vlerësimin e njohurive gjatë dhe në fund të semestrit.</p>

nga titullari i lëndës/modulit.				
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive për studentët përfshijnë forma dhe mënyra të ndryshme që reflektojnë angazhimin e tyre në dhe jashtë auditorit, të tilla forma janë diskutime në seminar, detyrat e kursit të përgatitura jashtë auditorit dhe të mbrojtura në auditor, testimi i ndërmjetëm, testimi përfundimtar etj.</p> <p><i>Megjithatë mungesa e praktikës profesionale në këtë program nuk arrin që të vlerësohen të plota aftësitë profesionale të studentit gjë që është rrjedhojë e mos koordinimit siç duhet të njohurive teorike me ato praktike drejtpërdrejt në sektorin e financës.</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 2.8, 1.5)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>Bazuar në syllabuset e programit si dhe verifikimin pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit të Ekonomisë evidentuam që testimi dhe vlerësimi i njohurive realizohet në mënyrë të vazhduar gjatë dhe në fund të semestrit me një raport strukture mes tyre 60 % me 40 % në favor të provimit përfundimtar.</p> <p>Në vlerësimin përfundimtar të studentit në një disiplinë të caktuar merren në konsideratë të gjitha elementet përbërëse të zhvillimit të lëndës: pjesa teorike, pjesa e seminareve, projektet, kontrollat e pjesshme, etj. Këto elementë vlerësimi gjenden në secilin nga syllabuset e lëndës të përgatitur nga titullari i saj dhe miratuar nga përgjegjësi i Departamentit. Rezulton se mënyra e vlerësimit të vazhduar të lëndës (me shumë elemente vlerësimi) bën të mundur kontrollin e dijeve më mirë nga ana e pedagogut dhe në të njëjtën kohë nxit studentin për përgatitje më sistematike gjatë gjithë semestrit në të gjithë elementët e vlerësimit të lëndës.</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni siç e kemi theksuar edhe më lart ofron platformën elektronike UVMS që është efektive në dhënien dhe marrjen e informacionit për stafin akademik dhe studentët.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Mbështetur në kuadrin rregullativ të brendshëm, drejtuesi i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit para se të shpallen datat e provimeve përcakton komisionet e provimeve të cilët janë jo më pak se dy anëtarë dhe ja çon për miratim dhe shpallje Zv.dekanit për anën mësimore. Komisioni përbëhet nga titullari i lëndës dhe asistenti i tij. Nëse lënda nuk ka asistent caktohet një anëtar që

	zhvillon një lëndë të përafërt apo të fushës.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Testimi i vlerësimit të njohurive realizohet me shkrim (përveç dy lëndëve që zhvillohen me goje) pa sekretim dhe kodifikim ku komisioni i provimit është përgjegjës për mbarëvajtjen e tij. Ambientet që ofrohen për realizimin e testimit të njohurive janë të përshtatshme për të siguruar hapësirën e duhur mes studentëve. Në rast se koencidon datë provimi edhe në lëndë të kurseve të tjera alternohet orari i kryerjes së provimit. <i>Njësia bazë e programit duhet që të aplikojë sa më shpejt sekretimin e procesit të realizimit të provimit gjë që nuk bëhet deri tani. (Aneksi nr. 1.3; 2.1; Evidenca C)</i>
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Përpara fillimit të provimit titullari i lëndës orienton në vija të përgjithshme studentët. Rezultatet e testimit shpallen paraprakisht jo më vonë se 2 ditë kalendrike dhe hidhen në platformën UVMS. Pas kësaj caktohet data kur studentët kanë të drejtë të shikojnë testin e korrigjuar dhe të bëjnë reklamimin e duhur nëse kanë. Reklamimi sqarohet nga titullari i lëndës në prani të studentit. <i>(Aneksi nr. 1.3; 2.1; Evidenca C)</i>
Kriteri 6. Njësiti përgjegjës dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Institucioni e ka të sanksionuar në Kodin e Etikës të miratuar më datë 7.01.2014, nenin 9 ndalimin e kopjimit nga ana e studentëve. Në funksion të këtij neni titullari i lëndës gjatë testit të ndërmjetëm dhe Komisioni i Provimit kanë përgjegjësinë e një monitorimi të rreptë me qëllim shmangien e kopjimit nga studentët.
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Stafi akademik i programit synon një vlerësim sa më të drejtë të dijeve duke u bazuar tek merita dhe për këtë qëllim përdor të gjitha format e kontrollit të dijeve që kemi përmendur më lart. Nga takimi me studentët nuk u evidentuan raste të vlerësimit të pamerituar. Takimi i titullarit të lëndës me grupin e studentëve lidhur me diskutimet apo reklamimet për vlerësimet që bëhen pas marrjes së vlerësimit paraprak bëhen transparente në grup. Nga grupi i studentëve nuk u evidentuan vlerësime të pamerituara.
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Procedura deri në vlerësimin përfundimtar dhe dorëzimin e procesverbalit në sekretarinë mësimore përfshin dhe momentin e njohjes paraprake të studenteve me vlerësimin, takimin me titullarin e lëndës, reklamimin e mundshëm dhe ballafaqimin me rezultatin dhe korrigjimin e testit. <i>(Aneksi nr. 1.3; 2.1 dhe Evidenca C)</i>
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Procedura e rasteve të ankesave është e plotë dhe e qartë në rregulloret përkatëse të Departamentit dhe programit. Në të përcaktohet ngritja e Komisionit të posaçëm për të shqyrtuar ankimimin. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët gjatë 3 viteve të fundit nuk kishte një praktikë lidhur me këtë problem.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Bazuar në planin mësimor të këtij programi arrihet që studenti të pajiset me zotërimin e njohurive bazë teorike dhe deri diku praktike të problemeve financiare e bankare duke u dhënë mundësi të gjejnë veten në tregun e punës në sektorin financiar e bankar në pozicione bazë të tilla si ekonomistë të financës, në sektorin publik e privat të ekonomisë, arkëtarë apo shërbim llogarie pranë bankave tregtare, institucioneve të sigurimit etj. Gjithashtu, zotërimi i njohurive bazë mësimore e shkencore të marra i bën studentët të suksesshëm në vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë të programeve universitare atë të Masterit Shkencor apo Masterit Profesional.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Ky program studimi përfshin edhe lëndë të tilla që u japin njohuri studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit komunikimit dhe ndërveprimit. Kjo arrihet nëpërmjet lëndëve “Sistemet e Informacionit në Ekonomi” dhe “Komunikimi në Botën e Biznesit” si lëndë me zgjedhje dhe “Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi në Ekonomi”. Gjithashtu programi përfshin dhe lëndën e gjuhës së huaj (një nga katër gjuhët e huaja më të përdorura në Shqipëri) (Aneksi nr. 1.4)
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Nga takimi me stafin e programit dhe studentët evidentuam që në orën e fundit të leksionit bashkëbisedojë mes pedagogut dhe studentit realizimi i programit të lëndës (bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit).
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Në takimin me stafin akademik të programit u evidentua që pedagogu i lëndës përkatëse në fund të zhvillimit të mësimin bën një përmbledhje të temave të trajtuara dhe orienton studentët lidhur me testin përfundimtar që do zhvillohet në sezonin e provimeve.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga takimi me stafin e programit dhe studentët evidentuam që risitë e reja lidhur me njohuritë në lëndët përkatëse diskutohen kryesisht në orën e mbrojtjes së detyrës së kursit të cilat edhe i referoheshin praktikave më të reja. Nga shqyrtimi i dokumentacionit gjatë tre viteve të fundit njësia

	kryesore/bazë kanë organizuar dy leksione të hapura me referues të huaj dhe profesorë të njohur të ekonomisë dhe financës.			
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Bazuar në takimin e zhvilluar me stafin e programit, GVJ evidentoi që anëtarë të tij realizonin zhvillimin e programit në tema të caktuara nëpërmjet punëve laboratorike. Më e theksuar është në lëndët "Kontabilitet i Aplikuar" dhe "Ekonometri". Në përputhje me këtë qëllim edhe detyrat e kursit zhvillohen dhe mbrohen në formën e analizave të rasti në laborator.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Forma e bashkëbisedimit mes titullarit dhe grupit të studentëve është mënyra kryesore që përdoret për analizën e problematikave të ndryshme. Nga takimi me grupin e studentëve evidentuam se forma e bashkëbisedimit studentë-pedagogë, është kryesore që përdoret për problematikën në mësimdhënie.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Stafi akademik i programit ka mbështetur studentët në përpjekjet modeste të tyre (si program i ciklit të parë) lidhur me angazhimin në evenimente shkencore. Këtu kemi parasysh organizimin e konferencës studentore në vitin 2017. <i>Mendojmë që institucioni dhe njësia kryesore/bazë duhet të rrisë angazhimin në këtë drejtim që përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor apo evente të organizimit të konferencave të tyre të jenë të përvitshme në institucion apo edhe pranë institucioneve të tjera. Një drejtim tjetër ku duhet të intensifikohet angazhimi i stafit akademik dhe institucionit është edhe realizimi i më shumë mobiliteteve për studentët pranë universiteteve homologe dhe përfshirja e tyre në projektet ku institucioni është partner gjë që është ende e pakët.</i> (Aneksi nr. 1.6; 1.9, 1.9.1; Evidenca K dhe L)			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.				
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Marrja e përvojës mësimdhënëse nga universitete homologe të huaja është një drejtim tjetër i përmirësimit të këtyre formave. <i>Numri i kufizuar i mobiliteteve të realizuara për stafin e programit (gjithsej 4 të tilla) megjithë përfitimet që ka sjellë ende është i pamjaftueshëm për të arritur plotësisht plotësimin me format bashkëkohore të mësimdhënies.</i> (Aneksi nr. 1.6; 1.9, 1.9.1; Evidenca K dhe L)			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit**

dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në bazë të 3 rregulloreve mësimore të përmendura më lart studentët e këtij programi pas përmbjlljes së gjithë detyrimeve kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës nëpërmjet provimit të formimit apo punimit të diplomës. Procedura e mbrojtjes përfundimtare të diplomimit, është e përcaktuar në rregulloren e Institucionit dhe rregulloren e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit dhe akoma me e detajuar është në rregulloren e këtij programi studimi e miratuar në Dhjetor 2019. Në nenet 13 dhe 14 të kësaj rregulloreje jepet i detajuar procesi i diplomimit të studentëve që përfundojnë gjithë kursin e plotë të studimeve Bachelor në 'Financë'. <i>(Aneksi nr. 1.3, 2.1)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Struktura përgjegjëse që monitoron dhe realizon procesin e diplomimit të studentëve është njësi baze, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit. Kjo strukturë informon studentët që në fillim të nisjes së programit mbi kriteret e përcaktuara për mbrojtjen e diplomës ku vlen të theksohet kriteri i përfundimit të të gjitha detyrimeve të programit. Studentët njihen që në fillim të programit me një nga dy format e mbrojtjes se diplomës; provim me gojë ose punim diplome, ku kriteri është nota mesatare që është 9. Studentët që e kanë notën mesatare poshtë kësaj note do e mbrojnë diplomën me anën e provimit të formimit me gojë, ndërsa mbi këtë notë mesatare studentët do e mbrojnë diplomën përmes përgatitjes dhe mbrojtjes të një punimi. <i>(Aneksi nr. 1.3, 2.1)</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në nenin 14 të rregullores të këtij programi studimi përcaktohet qartë procedura e mbrojtjes se diplomës në të dyja format e përmendura më lart. Ky proces fillon me propozimin nga përgjegjësi i Departamentit dhe miratimin nga dekani i Fakultetit të Ekonomisë të Komisionit të Provimit të Diplomës. Në çdo rast ky komision që përbehet nga jo me pak se 5 anëtarë, në vlerësimin e studentit në mbrojtjen e diplomës bazohet: <ul style="list-style-type: none"> ➤ Për studentet që mbrojnë diplomën me provim me gojë vlerësimi bazohet në përgjigjen e pyetjeve të tezës së provimit dhe ecurinë në mësimet të studentit gjatë 3 viteve. Tezat e provimit të formimit kanë jo me pak se tre pyetje. Pyetjet janë kryesisht nga lëndët karakterizuese që kanë kodin FIN dhe që janë përgatitur nga titullari i lëndes. ➤ Për studentet që mbrojnë diplomën me anën e punimit vlerësimi bazohet në cilësinë e punimit të diplomës të paraqitur, në vlerësimin e udhëheqësit të punimit dhe ecurinë në mësimet gjatë tre viteve të studentit. Mbrojtja e diplomës në këtë formë bëhet e hapur .

	GVJ evidentoi një praktike të tilla e cila rezultoi e plotësuar. (Aneksi nr. 1.3, 2.1)
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Personeli akademik i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit si njësi përgjegjëse e diplomimit orienton studentët për përgatitjen e provimit final apo përgatitjen e punimit të diplomës. Në rregullore përcaktohet se “Banka e të gjitha pyetjeve u vihet në dispozicion studentëve të paktën 3 muaj para provimit të diplomimit”. Në këtë kuadër studentët kanë kohën e nevojshme jo vetëm për të siguruar literaturën e nevojshme të provimit përfundimtar, të parapërgatitjes por edhe për të sqaruar paqartësitë lidhur me pyetjet orientuese të marra. Në rastin e studentëve që do mbrojnë diplomën me punim Departamenti merr informacion nga sekretaria mësimore dhe përcakton listën e studentëve që plotësojnë kriterin e notës dhe njëkohësisht informon studentët për fushat kryesore ku ata do përgatisin punimit. Fushat kryesore orientuese propozohen nga pedagogët titullarë të lendeve kryesisht karakterizuese dhe miratohen në Departament. Studenti bën kërkesën pranë Departamentit ku përcakton fushën e punimit. Departamenti në bazë të fushës së propozuar përcakton dhe udhëheqësit e punimeve të studentit duke bërë edhe një farë shpërndarje uniforme mes tyre. (Aneksi nr. 1.3, 2.1)
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni dhe njësi kryesore/bazë ndihmon studentët që janë në prag të mbrojtjes së diplomës duke ofruar në shërbim të tyre laboratorin e Informatikës, si dhe konsultimin mes stafit akademik apo pedagogëve udhëheqës me studentët para diplomimit. (Aneksi nr. 1.4)
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Pedagogët udhëheqës të punimeve të diplomave të studentëve ndjekin dhe ndihmojnë këta të fundit në realizimin sa me cilësor të punimit. Nga takimi me stafin e programit dhe studentët evidentuam që ndihma kryesore për ta është orientimi në gjetjen e të dhënave dhe metodologjia që duhet të ndjekin në përgatitjen e studimit. Për vetë faktin se kemi të bëjmë me punim diplome të nivelit të parë, punimet fokusohen kryesisht në raste studimore duke i dhënë me shumë karakter praktik të punimit. Udhëheqësi i diplomës e dorëzon vlerësimin e tij mbi cilësinë e punimit të diplomës përpara mbrojtjes dhe vetëm pas saj Komisioni i Provimit të Diplomës e konsideron të mirëqënë të drejtën për të mbrojtur punimin nga studentit.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë në të dyja format e mbrojtjes. Në procesverbalin e provimit të diplomimit që është i veçantë nga procesverbalet e lëndëve/moduleve vendosin vlerësimin me notë secili nga 5 anëtarët e komisionit. Nota përfundimtare del si mesatare aritmetike e 5

	vlerësimeve. (Aneksi nr. 1.4, 2.1; Evidenca C)			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Studentët e programit të studimit Bachelor në “Financë” të cilët kanë plotësuar detyrimet e këtij programi studimi dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit pajisen me diplomën , formati i të cilës është miratuar nga instancat përkatëse. Diploma e programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Financë” shoqërohet me listën e notave dhe me suplementin e diplomës. Suplementi i diplomës është në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës. (Evidenca C)			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studentëve të cilët kanë përfunduar programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Financë”, u vihet në dispozicion diploma dhe suplementi i diplomës së bashku me listën e notave, ndërsa programi i plotë i studimit u vihet në dispozicion vetëm pas kërkesës së studentit. (Evidenca C)			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	GVJ evidentoi pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit të Ekonomisë, mbajtjen e regjistrave bazë të studentëve me të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas standardeve shtetërore. Regjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme. Sekretaria mësimore e Fakultetit të Ekonomisë përpilon, administron dhe është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit themeltar (bazë) të shkruar me dorë dhe me kompjuter. Regjistri themeltar plotësohet me shkrim, pa korrigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Pas përcaktimit të nevojave nga Departamenti Financës dhe Kontabilitetit dhe përcjelljen e tyre nga Dekanati në Rektorat, procesi i rekrutimit të personelit akademik efektiv apo me kontratë dhe të ftuar koordinohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës, si pjesë e Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore.</p> <p>Ky sektor është krijuar me Vendim të Senatit Akademik Nr 8, të datës 14.02.2018 dhe ka përgjegjësi për menaxhimin e dosjeve personale të stafit përfshirë ato të stafit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ duke i ruajtur e përditësuar me të dhënat më të fundit, bazuar në shkresën 205/1 prot, datë 14.02.2018 të Rektorit dhe Administratorit të UV-së. Gjithashtu, UV ka ngritur në strukturën organizative të tij Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik i cili në bashkëpunim me Drejtorin e Komunikimit dhe BNJ administron dosjet me informacion të plotë në lidhje me kërkimin shkencor dhe promovimin akademik të personelit akademik.</p> <p>Nga vizita e realizuar në Drejtorinë e Komunikimit dhe BNJ, drejtues të saj na bënë me dije se drejtoria ka tre sektorë, sektorit i BNJ, i IT, dhe Komunikimit. Kjo drejtori është krijuar në Mars të vitit 2018.</p> <p>Nga dosjet e personelit akademik të shqyrtuara (3 dosje), rezultuan se të dhënat në lidhje me titujt e fituar në kohë dhe karrierën përditësohen duke plotësuar informacionin por nuk mban informacion lidhur me angazhimin e çdo PAE, PAK apo personelit ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ në çdo semestër dhe vit akademik, pasi këto të dhëna mbahen vetëm nga njësia bazë. Sektori i Burimeve Njerëzore, informacionin e përditësuar që disponon e ruan në arkivën e IAL-së.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në nenin 51 të Statutit të UV për punësimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik në përputhje me bazën ligjore në fuqi sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës ndjek procedurat për rekrutim sipas kërkesave të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p><i>Në disa prej praktikave të verifikuara gjatë vizitës në IAL u evidentuan se disa kritere për rekrutim të stafit akademik të përcaktuara nga njësia bazë përmbajnë specifitime që vështirësojnë procesin e pasjes së kandidatëve që mund të hyjnë në procesin e rekrutimit. Përgjithësisht në praktikat e verifikuara numri i aplikantëve të trajtuar në procesin e vlerësimit ishte 2-3 kandidatë. UV e ka arritur pjekurinë të kërkojë të rekrutojë vetëm</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të</p>	

përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

staf akademik me grada shkencore dhe tituj akademik.

GVB shprehet se njësia bazë sipas nevojës për staf akademik përcakton kriteret e përgjithshme dhe kriteret specifike, i miraton në mbledhjen e Departamentit, e më pas i përcjell për miratim të mëtejshëm tek Dekani dhe Rektori dhe i publikon në web të UV¹.

GVJ konstaton se në nenin 51 të Statutit të UV të miratuar nga MASR për punësimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik përcaktohet se kriteret përcaktohen nga njësia bazë dhe miratohen nga Rektori, pa u kërkuar të miratohen nga Dekani dhe pastaj nga Rektori. IAL duhet të ndryshoj Statutin e tij ose të rishikoj hapat që ndjek për të qenë në përputhje me Statutin e tij.

Gjatë vizitës në IAL drejtues të kësaj drejtorie u pyetën nëse kanë rregullore të veçanta ku mbështeten për procesin e rekrutimit. Nga përfaqësuesi i IAL-së na u tha se nuk kanë rregullore por mbështeten në statutin e UV.

GVJ referuar të gjitha sa më sipër dhe eksperiencave të mira që ekzistojnë i rekomandon IAL-së se duhet të ketë një rregullore të rekrutimit të stafit të UV ku të pasqyrohen kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta për kategoritë asistent lektor, lektor dhe profesor me qëllim që në procesin e rekrutimit, njësia bazë dhe gjithë strukturat e tjera përfshirë këtu edhe sektorin përgjegjës të rekrutimit të kujdesen rigorozisht për respektimin e neneve të rregullores.

Gjithashtu, palët e interesuara për monitorim apo observim të këtij procesi do të kenë një bazë të shkruar për referencë. Kështu nuk ngelet evaziv përcaktimi i kriterëve kryesore të rekrutimit dhe ndryshimi i tyre për çdo rast, duke krijuar përshtypjen se kriteret ndërtohen sipas kandidatëve të paracaktuar të fitojnë pozicionin e punës. Pra, në rregulloren që rekomandohet të hartohet bazuar në statutin e UV-së, krahas përcaktimit të hapave që duhen ndjekur dhe strukturave përgjegjëse të angazhuara, duhet që në shtojcën e saj të gjenden të pasqyruara kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta për kategoritë asistent lektor, lektor dhe profesor. Në këto kriteret të përfshihen nota mesatare e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, profili i studimit, shkollimi dhe kualifikimi i mëtejshëm, përvoja e punës në mësimdhënie, kualifikime brenda apo jashtë vendit, njohuri të gjuhëve të huaja, aktiviteti botues shkencor, etj. Të gjitha këto të shoqëruara me pikët respektive për procesin e vlerësimit që kryhet nga komisioni Ad-hoc.

¹ <https://univlora.edu.al/njoftime-puncesimi/>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Universiteti "Ismail Qemali" megjithëse prej shumë vitesh nuk i janë krijuar mundësitë për godina apo kampus dedikuar këtij Universiteti në qytetin e Vlorës, mund të shprehim se prej vitesh drejtuesit e UV-së janë angazhuar herë pas here në meremetime dhe adaptime të hapësirave disponibël në funksion të nevojave të personelit akademik të tij me qëllim krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme për kryerjen e detyrave të tyre si në aspektin e kushteve por edhe të mundësive për të marrë informacionin e nevojshëm përmes internetit, bibliotekave dhe sistemeve të informacionit.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, konstatoam se personeli akademik i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit nuk ka zyra të veçanta për cdo PAE por ata janë të grupuar. Megjithatë, secili prej tyre zotëron një post pune të pajisur me një PC ku mund të punojë në mënyrë të pavarur.</p> <p>Mjediset ku zhvillohet mësimi, si auditore dhe klasa, kishin përmirësime duke plotësuar kriteret e nevojshme për të zhvilluar procesin e mësimdhënies në mënyrë sa më cilësore, pavarësisht se nuk evidentuam mundësimin e projektorëve për disa salla.</p> <p><i>Në mjediset e IAL-së mungonte sistemi wireless i aksesueshëm për studentët duke penguar aksesin e tyre në webs të nevojshëm për procesin mësimor.</i></p> <p>Sekretaria e Fakultetit të Ekonomisë luan një rol shumë të rëndësishëm dhe mbështetës në përmirësimin e kontaktit ndërmjet studentëve dhe stafit akademik, stafit administrativ por edhe drejtuesve të Departamentit dhe Fakultetit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UV ka vijuar një traditë shumë të mirë për mbështetjen e plotë që i afrohet stafit të tij akademik për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të tyre si edhe mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore e publikime në revista shkencore, bazuar këto edhe në statutin e UV neni 46, pika 1, gërma a dhe b. Kjo është një nga eksperiencat e mira që gjendet në këtë universitet duke e bërë këtë një shembull edhe për universitetet e tjera publike.</p>

	<p><i>Megjithatë, akoma më shumë aktive duhet të ishin zyrat përkatëse por edhe vet pedagogët në përfshirjen në projekte ku mund të siguronin mbështetje të mëtejshme për zhvillimin e tyre profesional dhe kërkimor duke qenë se drejtuesit e UV-së e kanë vënë theksin në mbështetjen e plotë që japin për çdo PAE me qëllim shkrimin dhe përfshirjen në projekte shkëmbimi ndërkombëtare në mësimdhënie, kërkim dhe bashkëpunim me universitete dhe partnerë të tjerë kudo në botë, referuar evidencës D².</i></p> <p><i>(Evidenca I dhe J)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>GVJ referuar RVB-së shprehet se UV përmes “Planit Strategjik 2018-2024” (Evidenca B, faqe 24) synon të jetë një institucion aktiv në implementimin e dijes, gjenerimin e ideve krijuese dhe nxitjen e shkencës. Për arritjen e këtij qëllimi, stafi akademik inkurajohet në mënyrë të vazhdueshme prej të gjitha niveleve drejtuese për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja. Edhe pse është miratuar me vendim rektorati nr. 1, datë 13.01.2020 (Evidenca N) një udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, universiteti ende nuk ofron programe specifike me qëllim kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshanon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ referuar RVB-së shprehet se për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të parë Bachelor në “Financë”, stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie dëshmon një angazhim të kënaqshëm në arritjen e këtij qëllimi.</p> <p>Në raportin e hartuar nga GVB evidentohet se ndarja e ngarkesës mësimore për secilin anëtar të stafit akademik bëhet nga drejtuesi i Departamenti në një shpërndarje optimale të ngarkesës së punës dhe specifikisht të ngarkesës mësimore ndërmjet stafit duke e orientuar atë në këtë mënyrë në përmbushjen e objektivave të këtij program studimi. Ndërsa, GVJ gjatë takimeve në IAL, pyeti lektorët për këtë ngarkesë të madhe orësh mësimore në auditor me përgjithësisht mbi 450 orë (Tabela 4, Aneksat e RVB) dhe raste me mbi 500 orë mësimore në auditor (Evidenca shtesë pas vizitës në IAL, “Ngarkesa mësimore viti akademik 2017-2020”). Dikush prej tyre u shpreh se “e kërkojmë vetë në departament ta marrim këtë ngarkesë sepse na duhet për të siguruar të ardhura shtesë përveç pagës bazë që kemi”.</p> <p>GVJ konstaton se ka mbingarkesë orësh mësimore maksimale për stafin akademik të angazhuar në këtë program. Kjo nuk siguron cilësi të punës së stafit akademik dhe mundësi për të pasur kohë dhe</p>

²<https://univlora.edu.al/2017/12/13/strategjia-e-nderkombetarizimit/>

	<p>përkushtim për kërkim shkencor prej tyre, pasi ngarkesa e tyre mësimore është shumë e madhe. Mungesa e cilësisë, e klasave të zhurmshme, rasteve të pedagogëve që nuk shpjegojnë por lexojnë prezantimet, etj janë konstatuar edhe në raportin e vlerësimit të cilësisë të kryer nga vet IAL. GVJ rekomandon marrjen e masave për lehtësimin e ngarkesës me orë mësimore të PAE me qëllim që ata të kenë kohën dhe energjinë e nevojshme për kërkim shkencor, pjesëmarrje në projekte kërkimore ku mund të gjenerojnë të ardhura shtesë për veten dhe Universitetin si edhe më shumë angazhim me studentin.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ referuar RVB-së dhe konstatimit nga vizitat në institucion shprehet se IAL disponon auditorë të përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Referuar sipërfaqes së shfrytëzueshme, FE ka një sipërfaqe prej 2360 m² e shfrytëzueshme në 2 fasha orare ndërsa Biblioteka ka një sipërfaqe prej 250 m² me kapacitet 70 vënde studimi. Studentët e programit Bachelor në “Financë” realizojnë mësimin në intervalin kohor 8.00-14.00, duke i krijuar mundësi studentëve për të shfrytëzuar ambientet dhe burimet e Bibliotekës edhe përtej këtij intervali.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Normativa e sipërfaqes së shfrytëzueshme për godinën e FE është sipas vendimit Nr 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre” Aneksi 1/C. Konkretisht ajo është 2360 *2 / 1694, 2.78 m² pasi ka një sipërfaqe prej 2360 m² për 1694 studentë dhe organizon mësim me dy fasha orare.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përbajnë aparataturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjithashtu, FE zotëron një laborator për realizimin e procesit mësimor për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Financë”. Laboratori ishte i pajisur me aparatatura elektronike të teknologjisë së informacionit dhe sinjal interneti.</p> <p>GVJ gjatë takimit me studentët prej përgjigjeve të tyre konstatoi se UV nuk ju afron mundësinë e aksesit në internet dhe ata kishin pretendime për ambiente rekreative.</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ referuar RVB-së dhe konstatimit nga vizitat në institucion shprehet se IAL disponon një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës specifike të disa prej lëndëve të planit mësimor të këtij programi si për shembull, Financa 5 dhe SPSS.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion pa se laboratori kishte një kapacitet pritës prej 25 studentësh, por edhe sipas RVB-së ky laborator ka patur përmirësim të ngadaltë në vitet e fundit dhe mbetet ende një ndër problematikat kryesore të FE-së.</p> <p>GVJ gjatë takimit me studentët prej përgjigjeve të tyre konstaton se ata nuk i zhvillojnë klasat e MIS apo IT në këtë laborator.</p> <p>Ky program studimi nuk e ka praktikën profesionale dhe veprimtaritë e tjera praktike në planin e tij mësimor.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi IV.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, ky institucion ka 3 (tre) Biblioteka me 3 (tre) salla leximi, me personel 4 (katër) vetë, me vendndodhje, përkatësisht: Biblioteka qendrore, në Godinën A (Rektorati), që mbulon dhe Fakultetin e Ekonomisë me personel 2 (dy) specialistë, Biblioteka B, në Fakultetin e Shkencave Humane me 1 (një) specialist (që mbulon edhe Fakultetin e Shëndetit Publik) dhe Biblioteka e re në godinën C, në Fakultetin e Shkencave Teknike me 1 (një) specialist/e.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion evidenton se UV vijon të evidentohet ndër Universitetet e tjera për angazhimin maksimal në ofrimin e kushteve dhe mundësive për Bibliotekën me qëllim që studentët dhe pedagogët e këtij institucioni të kenë mundësinë për rritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e kërkimit shkencor përmes literaturës në tekste e periodike në gjuhën shqipe e të huaj përmes regjistrimit të tyre në kartelat e regjistrimit por edhe literaturës në soft copy.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të</p>	<p>Sipas RVB, për këtë IAL në total fond i literaturës 1994-2016 (me blerje dhe dhurata, shqip dhe në gjuhë të huaj) është: 35' 000 tekste në kopje (copë) për rreth 15'000 tituj, nga të cilat blerje janë 29'730 kopje për 10' 883 tituj, përkatësisht në Bibliotekën A – 16'048 kopje për 3'679 tituj, në Bibliotekën B – 13'682 kopje për 4'704 tituj. IAL në vitin 2018 ka shtuar edhe një Bibliotekë të re në</p>




<p>gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>godinën C. Në veçanti, për vitin 2016-2017 koleksioni i bibliotekës së Fakultetit të Ekonomisë është pasuruar me 107 tituj, nga këto 32 anglisht, 75 shqip, me 1'032 vëllime në gjuhën shqipe dhe 48 vëllime në gjuhën angleze, totali 1'080 vëllime; Për vitin akademik 2017-2018 koleksioni i bibliotekës së Fakultetit të Ekonomisë është pasuruar me 35 tituj, nga këto 11 anglisht në 20 vëllime, 24 shqip në 333 vëllime, totali 353 vëllime.</p> <p>GVJ bazuar në Planin Strategjik 2018-2024 (<i>Evidenca B, pika 2.6, faqe 17</i>) konstaton se literatura e ofruar nga IAL është multidisiplinare nga 10 fusha të ndryshme studimi, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore për mbulimin e moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes të këtij programi studimi. Gjithashtu, aty studentët mund të gjenin të gjitha tekstet, skriptet, ciklet e leksioneve dhe materiale të tjera ndihmëse mësimore të cilat i kanë si tekste bazë në syllabuset e lëndëve të këtij programi.</p> <p>Si në çdo IAL publike gjithmonë ka vështirësi për të siguruar literaturën më të fundit për shkak të fondit të pakët në dispozicion për blerje. Megjithatë IAL është kujdesur vazhdimisht të plotësoj nevojat kryesore për literaturë, gjithashtu kjo IAL ka siguruar vazhdimisht libra apo revista shkencore të nevojshme përmes donacioneve nga institucione partnere apo miq të huaj në kuadër të projekteve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, si të gjithë universitetet e tjera publike mbështur prej MASR ka mundur për stafin dhe studentët shërbimin e Bibliotekës on-line "ULIBRARY"³ pa pagesë për studentët dhe stafin akademik.</p> <p>GVJ nga RVB por edhe gjatë bisedës me punonjësit e Bibliotekës evidentoi se IAL përmes angazhimit të tij ka siguruar akses në softin Cobib.al për digjitalizimin e katalogut bibliografik të koleksionit të Bibliotekës, përditësohen tekstet dhe artikujt shkencorë si pjesë e rrjetit në sistemin ndërkombëtar Cobis.Net. Në këtë sistem studentët e këtij programi kanë kërkuar për materiale/tekste, artikuj digjitalë sipas manualit të librarisë digjitale. Gjithashtu, për Bibliotekën elektronike online është bashkëpunuar me Electronic Resources for Albania (ERA2012 Project), mbështetur nga Qendra Rajonale për Sistemet e Informimit Bibliotekar dhe Sistemet e Informacionit Kërkimor www.cobis.net; EIFL/ Informacioni Elektronik për Biblioteka www.eifl.net dhe</p>

³ <https://ulibrary.rash.al/>

	Akademia e Shkencave e Shqipërisë duke mundësuar për studentët akses të plotë në Library Academic Complete, EBSCO Academic Search Premier, Emerald Management e Journal Collection, Multi-Science Journals Collection, ProQuest Central, Taylor & Francis library, etj. Si edhe është përfshirë Biblioteka e UV në projektin e digjitalizimit të standardizuar dhe të unifikuar të librit/ tekstit mësimor apo artikujve shkencorë me rrjetin e Bibliotekave Universitare me lider Bibliotekën e Akademisë së Shkencave.		
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	GVJ gjatë vizitës në ambientet e Bibliotekës në godinën A ku zakonisht shkojnë studentët dhe stafi akademik i këtij programi u interesua për digjitalizimin e Bibliotekës. Stafi i Bibliotekës konfirmoi atë çfarë është shprehur edhe në RVB se vendimi i marrë nga Senati Akademik i UV për dixhitalizimin e Bibliotekës do të mundësojë një përfaqje moderne dhe akses të studentëve dhe pedagogëve në literaturën bashkëkohore.		
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	GVJ përmes vizitës në ambientet e Bibliotekës në godinën A të UV konfirmoi se: Në vitin akademik 2016-2017 fondi i Bibliotekës ishte pasuruar me librat e porositur sipas një buxheti të planifikuar që arrin në shifrën 100.000 lekë. Në vitin akademik 2017-2018 fondi i Bibliotekës ishte pasuruar me librat e porositur sipas një buxheti të planifikuar që arrin në shifrën 60.000 lekë. Në vitin akademik 2018-2019 sipas hartimit të buxhetit i cili për çdo vit konsideron kërkesat për tituj të rinj të kërkuar nga pedagogët, studentët, etj, kishte të planifikuar blerje në shifrën 80.000 lekë. (Evidencë Tabela: Blerja 1 2016-2017; Tabela: Blerja 2 (2017-2018))		
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ u bë me dije se Biblioteka e përdorur nga studentët e këtij programi është e hapur prej orës 08.00 deri në orën 20:00 nga e Hëna në të Shtunë duke iu krijuar studentëve mundësinë e shfrytëzimit në një fashë më të gjerë orare duke ju vendosur në dispozicion studentëve jo vetëm në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor por edhe në përgjigje të nevojave për studim të zgjatur të tyre. GVJ verifikoi në ambientet e Bibliotekës dhe website të UV-së dhe evidenton kujdesin e treguar në informimin e studentëve për oraret e studimit në Bibliotekë dhe stafi respektiv ⁴ që është në dispozicion për të asistuar ata për çdo nevojë në Bibliotekën e UV.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

⁴ <https://univlora.edu.al/biblioteka/>

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në IAL, duke ditur se sekretaria është struktura përgjegjëse për administrimin e të gjithë informacionit që lidhet me arritjet akademike deri në diplomimin e studentëve u krye një vizitë për të parë në vend ato çfarë janë shprehur edhe në RVB.</p> <p>GVJ evidentoi se për studentët e këtij programi regjistroheshin dhe mbaheshin të dhënat në formë të shkruar në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, neni 101. Krahas mbajtjes në formë të shkruar, sekretaria mësimore plotësonte edhe regjistrat elektronikisht. Rregjistrat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Regjistri themeltar të studentëve, Regjistri i arritjeve akademike ku hyn dhe procesverbali i çdo provimi apo detyrimi tjetër akademik, Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave. <p>UV ka progresuar krahasuar me universitetet e tjera publike ku shumica e tyre ende nuk kanë në përdorim sisteme të tilla. Përmes UVMS ju ofrohet mundësia studentëve të kenë në çdo kohë një pasqyrë të qartë orientuese, ndihmuese dhe transparente për ofertën akademike, administrative, sociale, kulturore e sportive të UV, brenda dhe jashtë procesit mësimor.</p> <p><i>Megjithatë, mangësi është që UV ende nuk ka një sistem menaxhimi informacioni të integruar për të gjithë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e stafit të UV të angazhuar në realizimin e këtij programi mësimor. Informacionet mbahen në tabela excel apo word.</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet</p>	

⁵ <https://uvms.univlora.edu.al/user/login>

drejtuese dhe titullarët.	UVMS garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët duke ju mundësuar edhe raporte statistikore mbi ecurinë akademike të studentëve, pagesën e tarifës së studimit etj.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ verifikoi dhe evidentoi se UV zotëron një faqe web ⁶ ku publikon informacione në gjuhën shqipe dhe angleze. Një pjesë e informacionit të publikuar lidhet me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<i>GVB lidhur me këto kriteret nuk ka të shprehur shifra sesa janë kostot në shifra për këtë program studimi. Kjo është një e dhënë e domosdoshme për më tepër kur ky program administrohet nga një departament finance dhe kontabiliteti. Por GVB nuk ka asnjë të dhënë. Veçse në nivel IAL-je hartohet një kosto mesatare studenti por në nivel Universiteti.</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	<i>Sipas GVB, UV nuk harton një plan financiar të dedikuar për këtë program studimi. Në fakt, hartimi dhe miratimi në total i buxhetit të Universitetit, pavarësisht nga burimet e financimit të tij, fillon nga njësitë bazë dhe duhej që aty të kryhej analiza e kostove. Gjatë vizitës në IAL, nga GVJ u pyetën nëse kryejnë analiza për koston në nivel Departamenti për këtë program mësimor dhe çfarë plane kanë lidhur me kostot për student të cilat vijnë në rritje në kushtet kur numri i studentëve është duke rënë në mënyrë drastike. Përgjigjet ishin se nuk kanë kryer analizë kostosh për këtë program studimi. Do të shikojnë se çfarë mund të bëjnë në të ardhmen për llogaritjen e koston për student për këtë program. (Evidenca J).</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifata e shkollimit	<i>Referuar RVB-së, konstatohet se UV ka ngritur Njësinë e Auditimit të Brendshëm në zbatim të nenit 116 të Ligjit Nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimin e senatit Nr.8, datë 14.02.2019, “Për miratimin e strukturës organizative dhe organigramës së Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë.</i>

⁶ <https://univlor.edu.al/>

<p>dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>GVJ referuar Raporti Vjetor për vitin akademik 2018-2019 evidenton se për vitin akademik 2018-2019, Auditi i Brendshëm ka realizuar 3 auditime dhe ka lënë rekomandime. Raportet e Auditi të Brendshëm janë pjesë e raportit vjetor për vitin akademik 2018-2019. Gjithashtu, UV i nënshtrohet edhe auditimit prej Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe MASR.</p> <p><i>(Evidenca J)</i></p>										
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p><i>Përgjigja e dhënë nga GVB nuk i jep përgjigje kriterit 4, kjo vjen si pasojë e mos pasjes së analizave dhe raporteve financiare për këtë program studimi.</i></p> <p>Ndërsa burimet e financimit të UV si një institucion publik mundësohen përmes: Grandi që akordohet prej MASR dhe Fondet e vetë Universitetit të cilat sigurohen nëpërmjet tarifave të regjistrimit dhe shkollimit të studentëve si edhe të ardhurat nga shërbime të tjera që ofron institucioni.</p>										
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Regjistrimet e studentëve në vit të parë për këtë program mësimor janë si në vijim:</p> <div data-bbox="587 907 1353 1310" style="text-align: center;"> <p>Nr. Studenteve të regjistruar</p> <table border="1" style="margin: 10px auto;"> <thead> <tr> <th></th> <th>2016</th> <th>2017</th> <th>2018</th> <th>2019</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Nr. Studenteve të regjistruar</td> <td>167</td> <td>112</td> <td>105</td> <td>65</td> </tr> </tbody> </table> </div> <p>Nëse nuk do të merren masa të menjëhershme, atëherë tendencat për studentë të regjistruar në vitin e parë për tre vitet në vijim mund të kenë një paraqitje të thjeshtë grafike si më poshtë:</p> <div data-bbox="603 1473 1369 1848" style="text-align: center;"> <p>— Nr. Studenteve të regjistruar - - - Forecast(Nr. Studenteve të regjistruar) - - - Lower Confidence Bound(Nr. Studenteve të regjistruar) - - - Upper Confidence Bound(Nr. Studenteve të regjistruar)</p> </div> <p><i>GVJ konkludon se IAL duhet të marrë masa për llogaritjen e kostove për student në këtë program studimi me qëllim kryerjen e analizave të nevojshme për mirëmenaxhimin e fondeve të marra nga</i></p>		2016	2017	2018	2019	Nr. Studenteve të regjistruar	167	112	105	65
	2016	2017	2018	2019							
Nr. Studenteve të regjistruar	167	112	105	65							

	<i>buxheti i shtetit dhe orientimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturën e UV-së në arritjen e misionit të tij përmes analizës dhe përcaktimit të strategjive konkrete për çdo njësi bazë, program studimi dhe jo pa asnjë studim tregu dhe analizë kostosh siç evidentuam për këtë program. Gjithashtu, stafi akademik duhet të përfshihet në më shumë projekte dhe kërkime me qëllim sigurimin e të ardhurave shtesë për IAL-në dhe veten e tyre, duke konsideruar projektet dhe kërkimet si burim të ardhurash dhe jo rritjen në maksimum të orëve mësimore në auditor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk është përmbushur	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk është përmbushur	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UV është kujdesur të hartojë dhe zbatojë rregullore dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, dhe udhëzimin e MASR, Nr. 10, datë 15.05.2019 si edhe Udhëzimin e MASR, Nr. 17, datë 30.07.2019 ⁷ për pranimin e studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Financë”.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Konkretisht për pranimet në këtë cikël studimi, Senati Akademik i UV-së ka miratuar dhe ka kaluar për zbatim kriteret e parashikuara në nenin 39 të rregullores së UV, e cituar në RVB si <i>Evidenca C</i> si dhe në kriteret sipas procedurës së pranimit të studentëve (<i>Aneksi 2.3</i>). Këto të fundit të propozuara nga vetë njësia bazë për miratim në Senatin Akademik. Gjithashtu, Senati Akademik ka miratuar në rregulloren e DFK-së, në nenin 21 të saj disa kërkesa për të drejtat dhe detyrimet e studentëve gjatë viteve të studimit.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ gjatë vizitës në sekretarinë e IAL-së u bë me dije se
Kriteri 4. Institucioni harton dhe	

⁷ <https://arsimi.gov.al/pranimet-ne-universitetet-publike/>

<p>publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>regjistrimi i studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Financë” kryhej pranë tyre duke respektuar renditjen sipas listave të publikuara të studentëve fitues⁸ duke garantuar barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student.</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Për tu evidentuar është edhe konstatimi i kryer në verifikim e bërë në ëeb të UV-së ku gjenden të publikuara të gjitha kriteret dhe procedurat që kanë të bëjnë me: pranimin, përzgjedhjen e studentëve, përparimin përgjatë kursit të studimit, transferimin, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit për cilindo prej studentëve që ndjek ciklin e parë të studimeve Bachelor në “Financë”.</p> <p>GVJ konstaton se UV është kujdesur plotësisht për hartimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të pranimit të studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Financë”. Konkretisht veprimtaria kryhet në përputhje me VKM mbi përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve (VKM 295, datë 10.05.2019) si edhe Ligjin Nr. 80/2015, Udhëzimet e MASR, vendimet e Senatit Akademik, etj., të cituara edhe në Kriterin 1 të këtij Standardi më sipër.</p> <p>Gjithashtu, pjesë e këtyre procedurave janë edhe kriteret e parashikuara dhe të publikuara nga UV lidhur me regjistrimin e studentëve sipas kategorive në kuota të veçanta, përfshirë këtu edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ në përgjigje të këtij kriteri po e ilustron përmes vendosjes bashkëlidhur si referencë vendimin e Senatit Akademik të UV-së, me Nr. 556/3 datë.20.04.2018 (<i>Ankesi 5.1</i>)⁹ të një prej vendimeve të publikuara (para plotësimit të formularit prej maturantëve) ku gjenden kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve të ciklit të parë të studimeve.</p> <p>Gjithashtu, sipas RVB konstatohet se UV përmes Sektorit të Këshillimit dhe Karrierës, Alumnit dhe Zyrës së Marketingut organizon takime me kandidatët për studentë të ardhshëm dhe vizita në ambientet e gjimnazeve të Qarkut Vlorë, e më gjerë, në bashkëpunim me DAR Vlorë dhe aktiviteteve nën koordinim e strukturave të MASR si dhe takime pranë Qendrave Rinore të qyteteve të ndryshme për të informuar dhe shpërndarë broshura informative (<i>Aneksi 5.2, 5.3</i>) për këtë program studimi. Në ambientet e UV organizohen gjithashtu aktivitete “Open days” në të cilat DFK shpalos ofertën e saj tek kandidatët potencial për student.</p>

⁸ <https://univlora.edu.al/2019/08/27/listat-e-fituseve-per-raundin-e-pare/>

⁹ <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/09/vendim-nr-19.pdf>

	<p>GVJ konstaton se pavarësisht përpjekjeve të bëra deri më tani nga UV dhe të cituara më sipër, UV duhet të jetë akoma më shumë e pranishme në medime të tjera komunikimi duke përcjellë imazh dhe reputacion të lartë për publikun të cilët influencojnë edhe rritjen e kërkesës për regjistrime në këtë IAL. Risku i tregut dhe ai reputacional është shumë vendimtar në procesin e përzgjedhjes së IAL-së nga kandidatët për studentë dhe prindërit e tyre. UV duhet të punoj për evidentimin bazuar në fakte të një reputacioni në ngritje të tij, përndryshe këto risqe do të vijnë të influencojnë tendenca rënëse të studentëve të regjistruar në këtë program dhe kështu kërcënohet edhe jetëgjatësia e këtij programi studimi.</p> <p>Në përfundim, lidhur me këtë standard GVJ konkludon se përveç kujdesit të treguar nga IAL për këtë standard, gjykon se nuk ka vend për risk material në këto kritere të trajtuara në këtë standard përderisa jemi në kushtet dhe rrethanat kur ky program studimi në këto vitet e fundit nuk ka arritur të plotësoj kuotat e miratuara por vijon rënien duke shkuar në nivelin e më pak se 50% të plotësimit të tyre.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>GVJ konstaton se UV ka miratuar në rregulloren e UV (<i>Evidenca C</i>)¹⁰ në nenin 75, 76, dhe 77 kriteret dhe procedurat për informimin e plotë dhe të hollësishëm për përparimin akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p>GVJ ka evidentuar edhe më herët në këtë RVJ, se UV ka një praktikë për tu vlerësuar pozitivisht përmes përdorimit të sistemit informativ UVMS i cili mundëson studentëve akses të plotë mbi procedurat e përparimit akademik të tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>GVJ konstaton se UV ka miratuar nenet 56, 57, 58 dhe 59 në rregulloren e UV (<i>Evidenca C</i>)¹¹ si dhe në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Financë” (<i>Aneksi 1.3</i>) në nenin 6, të tij gjenden kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve të mundshme nga kualifikimet e mëparshme ose studimet e pjeshme si edhe</p>

¹⁰ <https://univlora.edu.al/tregullorja/>

¹¹ <https://univlora.edu.al/tregullorja/>

	<p>transferimin e tyre në këtë program mësimor. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Konkretisht u evidentua se në fillim të çdo viti akademik, DFK nginte një komision ad-hoc për njohjen e lëndëve dhe krediteve respektive bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga sekretaria mësimore për studentët e interesuar.</p> <p>Konstatohet se të gjithë studentët e interesuar mund ta gjejnë lehtësisht këtë informacion në website të UV-së si edhe pranë sekretarisë mësimore që mbulon këtë program studimi. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren Universitetit.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në IAL si edhe përmes RVB-së evidenton se DFK në çdo fillim semestri për çdo vit akademik shpall në ambiente publike orarin mësimor: ditën, orën, sallën dhe personelin akademik përkatës, për çdo semestër. Gjithashtu, programi (syllabusi) i çdo lënde mësimore ka të përcaktuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve. Këto ju prezantohen studentëve në orën e parë të mësimit nga pedagogu i lëndës. Gjithashtu, këto informacione studentët mund ti marrin edhe përmes website të UV-së ku gjendet rregullorja e UV-së (<i>Evidenca C, respektivisht Neni 60, 61, 62 dhe 63</i>) dhe sekretarisë mësimore.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UV ka miratuar në rregulloren e UV, në rregulloren e këtij programi studimi si edhe në Vendimin të Senatit Akademik të UV-së me Nr. 09, datë 26.01.2017, Nr. 122/4 Prot, të gjitha kriteret e procedurat për kryerjen e punimit të diplomës dhe diplomimin në programin e studimit Bachelor në “Financë”. Gjithashtu, UV ka ndërtuar një procedurë (<i>Aneksi 3.19</i>) për diplomimin e studentëve në këtë program studimi.</p> <p>Të gjitha dokumentet e cituara më sipër gjenden online në website të UV-së si edhe pranë sekretarisë mësimore që mbulon këtë program studimi. Aty studentët të cilët ndjekin programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Financë” mund ti gjejnë lehtësisht të gjitha kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në këtë program.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ, në përgjigje të këtij kriteri referon konstatimet e saj të dhëna në standardin V.1. bazuar këto edhe në RVB për këtë program studimi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Përgjegjësi i grupit mësimor të Financës (i zgjedhur bazuar në nenin 77 të Statutit të UV-së), specialistët e Zyrës së Studentit ¹² si edhe drejtues të DFK-së informojnë studentët e këtij programi në mënyrë të hollësishme në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit Bachelor në plotësim dhe zbatim të neneve respektive të rregullores së Departamentit.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjithashtu, ky proces kryhet nga sekretaria mësimore që në momentin e regjistrimit dhe fitimit të statutit të studentit e në vazhdim përgjatë gjithë kohës që zgjasin studimet e tyre. UV i ka mundësuar studentëve të kenë akses në informacion, dokumentacion dhe udhëzimet përkatëse të nevojshme për zhvillimin e lëndëve dhe veprimtarive formuese të këtij programi studimi.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Referuar RVB-së dhe verifikimit të kryer nga GVJ, në faqen ëeb të Universitetit gjendet gjithashtu një hapësirë e dedikuar për studentët në të cilën marrin informacion në lidhje me oraret e provimeve, kalendarin akademik, bibliotekën etj, ndërkohë që nëpërmjet sistemit informativ UVMS, studentët marrin informacion mbi kurrikulat, regjistrimet në leksione dhe seminare, leksionet e postuara, sallat e mësimdhënies etj.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Referuar RVB-së dhe verifikimit të kryer nga GVJ, në faqen ëeb të Universitetit gjendet gjithashtu një hapësirë e dedikuar për studentët në të cilën marrin informacion në lidhje me oraret e provimeve, kalendarin akademik, bibliotekën etj, ndërkohë që nëpërmjet sistemit informativ UVMS, studentët marrin informacion mbi kurrikulat, regjistrimet në leksione dhe seminare, leksionet e postuara, sallat e mësimdhënies etj.
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Gjatë vizitës në IAL, dhe takimit me Sektorin e Këshillimit të Studentëve dhe Alumn-it ¹³ në UV, pyetëm dhe morëm përgjigje për veprimtarinë e tyre me shumë rëndësi për mbarëvajtjen dhe progresin e këtij programi mësimor. Ato shërbenin si një urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke krijuar kontakte me punëdhënësit potencialë, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit, si edhe bënë gjurmimin e tyre, për të cilën edhe vet kishin menduar të aplikonin edhe disa teknika të tjera për rritjen e rezultateve në këtë drejtim. Në UV, studentëve të këtij programi studimi ju vendosen në dispozicion informacion i mjaftueshëm dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij procesi. Gjatë vizitës në IAL, studentët e pyetur nga GVJ lidhur me kriteret

12 <https://univlora.edu.al/sektorit-i-keshillimit-te-studenteve-dhe-alumn-i/>

13 <https://univlora.edu.al/sektorit-i-keshillimit-te-studenteve-dhe-alumn-i/>

	<p>e këtij standardi, u shprehën shumë pozitivisht për aksesin dhe mundësit që UV ju ka ofruar. Konkretisht përmes javës së informimit, nga sekretaria mësimore, website i UV-së si edhe përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit, UVMS. Ky sistem është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët edhe në distancë nëpërmjet kodit të identifikimit dhe fjalëkalimit të siguruara pranë sekretarive mësimore sipas departamenteve përkatëse.</p> <p><i>Në përfundim lidhur me këtë standard, GVJ sjell në vëmendje të IAL-së se do të ishte e nevojshme ndërtimi i një strategjie efektive që IAL të sigurojë një bashkëpunim me gjithëpërfshirës me institucionet e pushtetit dhe qeverisjes lokale duke kërkuar mbështetje për këtë IAL përmes angazhimit të stafit dhe studentëve në projekte kërkimore dhe zhvillimore të cilat do të sjellin përfitim për të gjitha palët. Praktika të tilla të mbështetjes së fortë të universiteteve nga institucionet e pushtetit dhe qeverisjes lokale i ndeshim në të gjitha qytetet universitare në vendet e Evropës Perëndimore, por edhe në Shqipëri.</i></p> <p><i>Gjithashtu, duke ditur mbështetjen e pakursyer që jep Senati Akademik, Rektorati dhe BA për aplikimin dhe angazhimin e stafit të UV-së në projekte kërkimore dhe zhvillimore, risjellim në vëmendje se duhet gjetur mekanizmi i xhitës ndoshta edhe përmes mekanizmave para-konvencional që stafi akademik dhe zyrat përkatëse të jenë aktiv dhe eficient në aplikimin dhe fitimin e projekteve, pasi kjo do të ishte një tjetër strategji e mirë për përfshirjen e studentëve në tregun e punës qoftë edhe duke krijuar mundësinë e marrjes së eksperiencave të para dhe për më tepër që ky program studimi nuk ka as lëndën e praktikës të përfshirë në planin mësimor, krejt ndryshe nga çfarë ndeshim në programe të tjera të këtij lloji.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	GVJ gjatë vizitës në IAL, kërkoi të verifikojë ato çfarë evidentoheshin në RVB, se sekretaria mësimore e DFK disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, numrin e studentëve të regjistruar në programet e

<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p>GVJ konstatoi se të dhëna e cituara më sipër ruhen në formë të shkruar (hard copy) si dhe në formë elektronike në regjistrin themeltar sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 78 dhe 79 të Statutit të UV-së.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sekretaria zbaton me kujdes nenin 101 të LAL 80/15 si dhe në nenet 78 dhe 79 të Statutit të UV-së duke regjistruar arritjet akademike në formë të shkruar dhe elektronike të gjithë studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi e deri në diplomimin e tyre.</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Përveç formës tradicionale të shkrimit në regjistrat përkatës, të dhënat statistikore të studentëve të programit mësimor të ciklit të parë “Bachelor” në UV menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit UVMS në formë elektronike</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Sekretaria mësimore dhe zyrat e tjera që kanë akses në këto të dhëna kujdesen të ruajnë dhe përpunojnë të dhënat personale të studentëve bazuar në parimin e kofidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>UV ndërton raportin vjetor (<i>Evidenca J</i>) me të gjithë elementët përbërës për çdo vit akademik në bazë të evidencave dhe raporteve të përcjella prej njësive kryesore dhe njësive bazë, si dhe strukturave pranë Rektoratit. Ky raport ndërtohet në zbatim të udhëzimit MASR Nr.5 datë 19. 02. 2018. Ky raport përmban edhe profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. <i>GVJ konstaton se IAL duhet të bëjë më shumë për mbështetjen dhe gjurmimin e studentëve për punësimin e tyre, si dhe shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre qoftë edhe duke ofruar mundësinë e vijimit të kualifikimeve me kurse speciale që kërkon tregu i punës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse</p>	<p>UV ashtu si çdo IAL tjetër në zbatim të nenit 98 dhe 99 të Ligjit Nr. 80, 2015, të nenit 74 të Statutit të UV-së (<i>Evidenca A</i>) u garanton</p>

<p>e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>studentëve të drejtat të marrin pjesë në proceset e vendimmarrëse dhe këshilluese të UV-së.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Konkretisht studentët e UV-së përfaqësohen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ 2 studentë si anëtarë të Senatit Akademik të këtij universiteti; ➤ Janë ngritur Këshillat Studentorë në nivel njësie kryesore¹⁴; ➤ Përfaqësues i studentëve përmes zgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit të UV-së¹⁵ të mbajtura më 21.0 1.9019; <p>Bazuar në Statutin e UV-së (<i>Evidenca A</i>) në RVB, në neni 22 të tij, referuar për komisionet e përhershme sipas pikave 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 22, Komisionet e Përhershme kanë në përbërjen e tyre një student me qëllim përfshirjen tyre. Si p.sh. studentët përfaqësues në Senatin Akademik thuhet në RVB se kanë një përfshirje në mënyrë aktive në çdo vendimarrje në lidhje me procesin mësimor e më gjerë.</p> <p>UV përfshin studentët në vlerësimin real dhe konkretë prej tyre të procesit akademik bazuar në rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme përmes marrjes së mendimit të studentëve të UV-së me pyetësorët që përgatit dhe organizon NJBSCVI për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, dhe konkretisht edhe për programin mësimor Bachelor në “Financë”.</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program mësimor, u pyet nga GVJ mbi masat e marra për adresimin e gjetjeve të këtyre raporteve, u përgjigjen se nuk kishin shumë se çfarë të adresonin. Kryesisht njësia bazë ka kërkuar përmirësim infrastrukture që të adresoj gjetjet e raportit, pa shkuar në analizë më të thellë cilësore si teknikat dhe mënyrat e përdorura gjatë procesit të mësimdhënies nga PAE-të e angazhuara në këtë program.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Sipas RVB-së, hartimi i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Financë” në vitin 2011, është bërë në përputhje me bazë ligjore në fuqi për hapjen e programeve të Studimit, Udhëzimi i MAS Nr. 15, datë 04.04.2008. Ndryshimet, përmirësimet e këtij programi në vite janë bërë në referencë të ndryshimeve të bazës ligjore si dhe përshtatjes së programit të Studimit me nevojat e tregut.</p> <p><i>GVJ konstaton se për ato rishikime të vendosura në dispozicion nuk gjeti të ishin në mbështetje të ndonjë propozimi nga studentët apo nga analiza e anketimit të tyre apo analiza e tregut (kujtojmë këtu se studimi më i fundit i tregut është bërë që në vitin 2011); si edhe nuk është konsideruar vendosja e praktikës si pjesë e programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të</p>	

¹⁴ <https://univlora.edu.al/2019/06/25/njoftim-22/>

¹⁵ <https://univlora.edu.al/2019/02/15/njoftim-per-zgjedhjet-per-anetar-te-bordit-te-administrimit/>

<p>programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p><i>mësimor, por vërehet një numër i shtuar lëndësh dhe ngarkese orësh mësimore në auditor.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Ky program studimi ka në planin e tij mësimor lëndë që mundësojnë realizimin e procedurave për njohjen e studimeve të pjeshme të mëparshme të studentëve (<i>Aneksi 2.4</i>).</p> <p>Ashtu siç e kemi cilësuar edhe më sipër, teorikisht raportet e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve për këtë program mësimor bëhen objekt diskutimi dhe reflektimi mbi përfundimet e dala nga njësia bazë me qëllim që të merret në konsideratë mendimi i studentëve edhe për procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit.</p> <p>Përmes UVMS, studentëve të këtij programi u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.</p> <p>Gjithashtu studentët e pyetur gjatë vizitës në IAL, u shprehën se kurdo që kanë pasur ankimim të rezultatit apo nevojën për rishikim, kjo është mundësuar nga pedagogët brënda kohës prej 48 orësh. Nga UV këto janë mundësuar përmes hartimit të rregullores së universitetit në nenin 62 dhe 67 (<i>Evidenca C</i>)¹⁶ dhe rregullores së programit të studimit Bachelor në “Financë “ në nenin 11 (<i>Aneksi 1.3</i>).</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>	

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Në respekt të kërkesave ligjore, UV ka në organigramë Drejtorinë e Edukimit për Ciklin I & II¹⁷. Kjo drejtori kujdeset për shërbimin e informimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UV-së, konkretisht neni 77 i Statutit (<i>Evidenca A</i>) dhe neni 85 të rregullores së UV-së (<i>Evidenca C</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Gjithashtu, UV ka të angazhuara disa njësi brenda tij me qëllim ngritjen dhe funksionimin e një sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e</p>

¹⁶ <https://univlora.edu.al/rregullorja/>

¹⁷ <https://univlora.edu.al/administrata/>

<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>studimit. Konkretisht disa prej tyre janë: Sekretaria mësimore e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit; Koordinatori për marrëdhëniet me studentët për grupin mësimor të Financës; Sektori i Kurrikulave dhe shërbimit ndaj studentëve; Sektori i Këshillimit të Karrierës, ALUMNI.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Sektori i Këshillimit të Studentëve dhe ALUMN-it në UV, shërben për mbështetjen e studentëve në zhvillimin e tyre dhe mundësit që kanë për integrim në tregun e punës. Specialistët e këtij sektori janë ofruesit kryesorë të shërbimeve për studentët lidhur me studimin dhe mësimin, aplikimin dhe pranimin në programe për të studiuar, kurse akademike, progresin akademik dhe përfundimin e studimeve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

<p>Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UV në zbatim të detyrimit të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, pika 1, ka hartuar politika si dhe ka ngritur struktura në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Strukturat dhe parimet e funksionimit të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) i ka vendosur edhe në Kreun VIII,</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të</p>	

<p>ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>nenet 81, 82, dhe 83 të Statutit të UV-së. Gjithashtu, përmes Statutit është vendosur detyrimi i ngritjes së Komisioneve të Përhershme të Sigurimit të Cilësisë në nivel Institucioni për UV-në dhe njësisë kryesore në rastin konkret për Fakultetin e Ekonomisë. Në nenin 22, pika 2 dhe 3, të Statutit shprehet qartë mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në komisionet e përhershme të Sigurimit të Cilësisë (<i>Evidenca A</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Me qëllim fuqizimin dhe vendosjen e detyrimeve dhe procedura të posaçme për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies UV ka miratuar kërkesa për zbatim përmes nenit 84 të rregullores së Universitetit (<i>Evidenca C</i>), si edhe Vendimi i Senatit nr.21, datë 08.05.2018 “Për procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve”. Në këtë vendim janë përkthuar procedurat e përmirësimit të programeve të studimit, nga analiza e rezultateve të pyetësorëve deri në planin e masave që propozohet për përmirësim.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p><i>GVJ konstaton se UV në përmbushje të politikave të përmendura më sipër ka ngritur pjesërisht strukturat e nevojshme për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Veçse me Vendimin e Senatit Akademik nr.8 datë 14.02.2018 është arritur të riorganizohet si një sektor më vete NJSBCVI-ja. Gjithashtu, UV është në mos plotësim të kërkesave të statutit të tij (neni 22) pasi ende nuk janë përzgjedhur anëtarët e komisioneve të përhershme në nivel institucional dhe në nivel të njësisë kryesore, respektivisht KSBCI dhe KSBCF. Kuptohet që vonesa në krijimin dhe mbështetjen e tyre me staf dhe fisibilitetin e nevojshëm do të kërkojë akoma më shumë kohë prej tyre që të përpilojnë procedurat dhe strategjitë e nevojshme për të arritur objektivat që ju kërkojnë nga kuadri ligjor dhe rregullator si edhe praktikat më të mira në vend dhe rajon. Pozitiv është angazhimi që shfaqet nga drejtues të këtyre strukturave gjatë vizitës në IAL të cilët shprehën se krijimi dhe implementimi i këtyre dokumenteve përbëjnë njëkohësisht edhe një prej objektivave strategjik të UV-së.</i></p>
	<p>GVJ konstaton se UV përmes raporteve mbi analizën dhe vlerësimin e rezultateve të pyetësorëve të studentëve, për vitet e fundit akademike ka krijuar një bazë të mirë vlerësimi analitik dhe krahasues me qëllim përmirësimin e programeve mësimore të ofruara nga UV.</p> <p>Ndikim pozitiv në përmirësimin cilësor të UV-së ka dhënë akreditimi institucional i kryer në Maj 2017, përmes vlerësimit të jashtëm të shkallës së përmbushjes së Standardeve Shqiptare Shtetërore të Cilësisë, duke dhënë në 21 Shtator 2017 një vlerësim</p>

	<p>përfudimtar pozitiv me Vendimin nr. 71 të Bordit të Akreditimit (<i>Aneksi 6.1</i>) për akreditimin institucional me kohëzgjatje prej 3 (tre) vite akademike.</p> <p>Nga GVJ konstatohet me rëndësi të veçantë ndjekja cilësore dhe në kohë e rekomandimeve të dhëna me vendimin nr. 71, të datës 21/09/2017 të Bordit të Akreditimit. Për adresimin e rekomandimeve të këtij vendimi, UV në datë 22 Maj 2018 me vendimin nr. 29 të Senatit Akademik të UV-së (<i>Aneksi 6.2</i>) ka miratuar planin e veprimit në kuadër të rekomandimeve të Bordit të Akreditimit. <i>Por, vonesa në përpilimin e planit të veprimit ka penguar efektivitetin e masave të propozuara dhe të ndërmarra, pavarësisht se disa prej tyre janë adresuar mirë nga UV.</i></p> <p>Gjatë vizitës në IAL, u bëmë me dije se Sektori i SBCI ka ndërmarrë disa hapa që synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. Duke qënë se këtij sektori i është dhënë rëndësia e duhur paksa me vonesë, ky sektor ka mundur të vendosë pak gurë kilometrik por të qëndrueshëm.</p> <p><i>Në përfundim, GVJ rekomandon menjëherë të merren masat për zgjedhjen e anëtarëve dhe funksionimin e plotë të KSBCI dhe KSBCF, me qëllim zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve mësimore.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	GVJ evidenton se DFK është njësi kryesore që duhet të marrë përsipër të drejtën dhe detyrimin për përmirësimin dhe rishikimin e programit mësimor. Njësia bazë si udhërrëfyes për këto ndryshime duhet të ketë studimin e tregut të punës dhe nevojat e tij, literaturën bashkëkohore, mendimet e marra prej studentëve, bizneseve, alumni, dhe zyra të tjera në UV. DFK duhet të jetë gjithnjë në kërkim të përmirësimit të syllabuseve dhe riorganizimit të temave brenda çdo syllabusi, riorganizim dhe ndarje e duhur të krediteve midis lëndëve që formojnë e standardizojnë aftësitë e veçanta nga ato profesionale të studentëve të ciklit të parë Bachelor në
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi,	

<p>instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>“Financë”. Të gjitha këto bëhen me qëllim që studentët e diplomuar në këtë program të kenë marrë dijet dhe njohuritë e domosdoshme për tu integruar sa më shpejtë në tregun lokal, rajonal apo kombëtar të punës. <i>Për këtë program studimi është kryer studim tregu që në vitin 2011, që do të thotë se të gjitha ndryshimet e bëra në këtë program gjatë këtyre 8 vjetëve të fundit nuk janë inicuar dhe mbështetur nga analiza e tregut apo në një analizë të rekomandimeve të marra nga ALUMNI apo bizneset.</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Ndjekja e procedurave standarde dhe të dokumentuara për kryerjen e ndryshimeve në planet mësimore evidentohen për praktikën e kryera para vitit 2015 duke ndjekur hapa të standardizuar nisur nga propozimi prej Departamentit tek shqyrtimi dhe miratimi në Këshillin e Fakultetit, dhe në fund propozimi dhe miratimi prej Senatit Akademik të UV-së dhe njoftim të MASR-së kur ndryshimi ishte deri në 20% (<i>Aneksi 1.8</i>). Nëse ndryshimet preknin më shumë se 20% praktika është përcjellë për marrjen e miratimit prej MASR-së. <i>Kjo traditë duhej të kultivohej akoma më shumë në vitet në vijim me qëllim që IAL të ndërtonte një procedurë të kontrollit dhe manaxhimit të standardizuar përmes kanaleve përkatëse me qëllim përmirësimin e procesit por edhe rritjen e cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>UV ka ngritur NJSBCVI si dhe Drejtorinë e Edukimit të Ciklit të Parë dhe të Dytë për mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë. Pak rezultate të pritshme reale mund të ketë prej kësaj të dytës lidhur me shqyrtimin dhe miratimin e ndryshimeve në programet mësimore pasi pesha, profesionalizmi dhe përgjegjësia kryesore shkon tek njësi bazë (DFK) dhe më pas tek zv/Dekani akademik në nivel Fakulteti për përmirësimin e këtij programi mësimor.</p> <p>Ndërsa për këto 2 vitet e fundit akademike, ajo çfarë evidentojmë si pozitive dhe të faktuar për GVJ-në është zhvillimi për çdo semestër i anketimit të studentëve të programit Bachelor në “Financë” (të cilët kanë një llogari personale në UVMS dhe kanë frekuentuar qoftë dhe një lëndë të vetme përgjatë vitit akademik) për vlerësimin e cilësisë së programeve mësimore si dhe matjen dhe vlerësimin e mësimdhënies bazuar në pyetësorët e përbërë prej 14 pyetjeve të mbyllura dhe 2 pyetjeve të hapura, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikën më të mira sipas vlerësimit të studentëve.</p> <p>Nga RVB evidentohet se studentët kanë dhënë opinionet e tyre përmes pyetjeve të hapura për çdo pedagog që ka dhënë mësim në programin e studimeve të ciklit të parë Bachelor në “Financë”, si edhe për këtë vit akademik (2019-2020) do të zhvillohet për herë të</p>




	<p>parë pyetëtori i studentëve për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmës akademik dhe administrativ¹⁸.</p> <p>Përgjigjet e pyetësorëve të studentëve janë konkretizuar në Raportin e Analizës dhe Vlerësimin të Pyetësorëve të përgatitur nga NJBSCVI (<i>Evidenca K dhe Evidenca L, shkurtimisht janë “Raporti dhe Projekt Propozimet për rritjen e Cilësisë së programeve të Studimit” për vitet akademike 2017-2018 dhe 2018-2019</i>). Raportet janë diskutuar në njësinë bazë (DFK) nga ku janë dhënë edhe masat që ata kanë menduar se duhen marrë për përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>GVJ konstaton se masat që kanë propozuar dhe miratuar me vendimin e Senatit Akademik të UV-së (Aneksi 6.4), me nr. 17, të datës 28 Mars 2019 për përmirësimin e cilësisë si rrjedhim i analizave të kryera për rezultatet e pyetësorëve janë kryesisht kërkesa për IAL me qëllim përmirësimin e infrastrukturës dhe jo çfarë duhet të bëjë njësinë bazë dhe ajo kryesore për të adresuar gjetjet shumë interesante të evidentuara nga analiza e raporteve të kryera nga NJSBCVI me studentët e këtij programi. Gjithashtu GVJ i rekomandon Senatit Akademik, dhe Bordit të Administrimit të UV-së të kërkojnë një analizë (follow up) të zbatimit të detyrave apo masave për adresimin e gjetjeve, mangësive dhe rekomandimeve të evidentuara nga këto raporte për përmirësimin në vijim të cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësinë e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, ka përgjegjësinë që t’i ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve mësimore, të tregojë se po bën përpjekjet e mundshme për të përdorur në mënyrë efektive dhe efikase burimet e siguruar nga buxheti i shtetit, studentët e saj, etj., dhe të sigurojë që janë plotësuar standardet e cilësisë. Senati Akademik i UV-së si organi më i lartë akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë në UV.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të	

¹⁸ <https://univlori.edu.al/komisionet/>




<p>ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>UV me qëllim rritjen e cilësisë ka përdorur disa metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. Në fund të çdo viti akademik në këto 2 vitet e fundit, dhe ne shërbim të sigurimit të cilësisë, UV ka hartuar raportimin vjetor për analizën e procesit mësimor dhe kërkimor me të gjithë komponentët e tij.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Sipas RVB konstatohet se Raporti i Vetëvlerësimit i përpiluar prej Grupit të Vlerësimit të Brendshëm në nivel institucioni me qëllim akreditimin institucional të UV-së në vitin 2017, i ka shërbyer si një burim i rëndësishëm informacioni NJSBCVI dhe strukturave të tjera në IAL të angazhuara në përmirësimin e cilësisë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Referuar RVB-së, evidentohet se në fillim të çdo vitit akademik stafi i njësisë bazë kontrollon dhe vlerëson përmbajtjen e planeve mësimore, syllabuseve, etj., si edhe adreson në ato rekomandimet e vitit të mëparshëm akademik për përmirësim të mëtejshëm të tyre. Ndërsa përgjegjësi i DFK ka parë të nevojshme dhe ka aplikuar vëzhgime të drejtpërdrejta në auditor gjatë kryerjes së leksioneve apo seminareve me qëllim vlerësimin e cilësisë së programit të studimit. Gjithashtu, janë organizuar takime si psh ëorkshop-in me temë “Studentët dhe tregu i punës”¹⁹ me bashkëpunëtorë, ekspertë të jashtëm, punëdhënës të rrjetit Alumni të UV-së, me qëllim njohjen me eksperiencat dhe identifikimin e nevojave për përmirësim të kurrikulave dhe përshtatja e vazhdueshme e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës.</p>

GVJ i sugjeron IAL-së që përveç metodave që ai aplikon dhe atyre të cituara më herët nga GVJ duhet të përdorë edhe metoda dhe instrumenta të tjera të standardizuara të cilat ndihmojnë vlerësimin dhe ndërtimin e qëndrueshëm të cilësisë së programit të studimit, disa të tilla mund të jenë:

- *Rishikimi i syllabuseve, kurrikulave dhe procesit mësimor çdo semestër të inicohet nga Rektorati në drejtim të njësisë bazë dhe kryesore me qëllim analizën dhe azhornimin e tyre bazuar në studimet dhe nevojat e tregut, dhe opinonet e aktorëve të tjerë të cituar më herët në këtë RVJ. Procesi mësimor dhe përmirësimi i tyre janë përgjegjësi jo vetëm e njësisë bazë dhe asaj kryesore por edhe e zv.rektorit që mbulon anën mësimore, si edhe zyrat e tjera në IAL të cilat duhet të japin dakordësinë e tyre para se të kërkohet dhe*

¹⁹ <https://univlora.edu.al/2019/12/22/ëorkshop-me-tome-studentet-dhe-tregu-i-punes/>




	<p>merren vendime nga Senati Akademik me qëllim mirëmenaxhimin, testimin dhe kontrollin e tyre të vazhduar;</p> <p>➤ Vlerësimi 360 gradë si një teknikë koherente përëndimore e aplikueshme për vlerësimin e eprorëve, kolegëve dhe vartësve në universitete.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Sigurimi i cilësisë është një proces që përfshin disa struktura, palë dhe individë të cilët duhet të kenë detyra dhe përgjegjësi të ndara qartë dhe infrastrukturën e duhur, kështu sigurohet përkushtim i të gjithë aktorëve në sigurimin e cilësisë.</p> <p>Me qëllim granatimin e cilësisë, UV ka adresuar fillimisht përmes nenit 81, 82 dhe 83 të Statutit të tij (<i>Evidenca A</i>), si edhe përmes nenit 86 të rregullores së UV-së (<i>Evidenca C</i>) përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së këtij programi mësimor si edhe përgjegjësitë dhe detyrat e njëjve, individëve dhe palëve të angazhuara në sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë së programit të studimit.</p>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<p><i>GVJ si edhe më herët në këtë RVJ ka evidentuar se për plotësimin e këtij kriteri nevojitet ngritja e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Fakulteti, ku pjesë e tij do të jetë stafi i njësisë bazë dhe studentët e këtij programi mësimor. Pavarësisht se RVB evidenton se rolin e stafit të njësisë bazë dhe studentëve deri më sot e kanë luajtur Dekanati i cili ka mbështetur dhe orientuar politikat për zhvillimin e monitorimin e ofertës akademike të Fakultetit dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, GVJ përsëri shpreh se duhet adresuar menjëherë si domosdoshmëri dhe detyrim në zbatim të nenit 22 të Statutit të UV-së ngritja dhe funksionimi i plotë i këtij komisioni.</i></p> <p><i>Gjithashtu GVJ konstaton se pavarësisht një workshopit të kryer, nuk është bërë aq sa duhet lidhur me përfshirjen më të gjerë të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertë të jashtëm të cilët mund të japin ekspertizë të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</i></p>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe	

bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p><i>GVJ i sugjeron IAL-së:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>Organizimi i takimeve të herë pas herëshme me ekspertë, dashamirës dhe bashkëpunëtor të UV-së për të diskutuar standardet, sigurimin e cilësisë, procedurat e vlerësimit dhe interpretimin e rezultateve të vlerësimit.</i> ➤ <i>Pas çdo lloj vlerësimi dhe analize duhet të merren masat e nevojshme konkrete të përcaktuara në kohë për tu zbatuar dhe pas çdo semestri të vlerësohet progresi apo regresi dhe axhustimet e nevojshme që duhen bërë.</i> ➤ <i>Strategjitë për rritjen e UV-së dhe ruajtjen e cilësisë në të njëjtën kohë të analizohen në lidhje me zhvillimet dhe nevojat e ekonomisë dhe shoqërisë në rrafshin lokal, rajonal, dhe kombëtar brënda kapaciteteve të UV-së, mundësisë për mbështetje me fonde dhe tarifa, si edhe marrjes në konsideratë të orientimit strategjik të përgjithshëm kombëtar.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton me shumë vlerësim pozitiv për këtë IAL faktin se është ndër IAL-të e rralla të cilat respektojnë kërkesat e standardeve duke siguruar transparencë për publikimin edhe në faqen ëeb të UV-së të 2 Raporteve (20 dhe 21) për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve. Në këtë mënyrë sigurohet transparenca për studentët dhe të gjithë palët e interesuara. Ky është një standard i vendosur nga UV dhe meriton vlerësim.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Gjithashtu, këto raporte nga NJSBCVI janë përcjellë nëpërmjet shkresave zyrtare (<i>Evidencat K dhe L</i>) tek të gjitha njësitë kryesore dhe njësitë bazë të cilat kanë pasur detyrim ti përcjellin këto raporte dhe analizojnë me secilin prej anëtarëve të stafit akademik.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ evidenton si edhe më sipër në këtë RVJ se UV ka miratuar planin e masave për të adresuara gjetjet që synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara nga proceset e vetë vlerësimit, por ka ende për të bërë në këtë drejtim duke u bazuar në analiza të
Kriteri 4. Institucioni vlerëson	

²⁰ <https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/>.

²¹ <https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/>.




dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	thelluara, cilësore për te evidentuar masa konkrete dhe ndjekjen në plotësimin e tyre e cila duket edhe përmes rezultateve të semestrit të ardhshëm.			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas statutit të UV-së Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë së Institucionit është përgjegjës para Senatit për punën e tij lidhur me sigurimin e cilësisë në këtë IAL. Të gjendur në rrethanat e mos ekzistencës së tij nuk mund të vlerësohet puna që ka kryer për çështjet e menaxhimit të cilësisë, promovimit dhe monitorimit të aktiviteteve të sigurimit të cilësisë në UV si edhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në UV. Gjithashtu pas krijimit dhe vendosjes në efikasitet të këtij komisioni dhe komisionit tjetër në nivel njësie kryesore do mund të vlerësohet dhe shikohet impakti në procedurat e vlerësimit të UV-së.</p> <p>Referuar RVB-së, me qëllim ngritjen e kulturës së cilësisë UV organizon aktivitete dhe seminareve informuese me studentët, kryesisht në trajtën e fushatave informuese me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimin të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion (si për shembull plotësimi i pyetësorëve, pjesëmarrja në Sondazhin Kombëtar të Studentëve etj). Më specifikisht nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Takimeve të drejtpërdrejta me studentët në auditore; ➤ Publikimit të njoftimit në rrjetet promovuese online të Universitetit. ➤ Publikimit të njoftimeve në llogaritë personale në UVMS etj. <p>Në përfundim, GVJ shprehet për përmbushje të këtij standardi duke u bazuar kryesisht në faktin e transparencës së qartë që IAL ka ekspozuar për publikun, duke treguar se UV nuk tenton të mbulojë çështjet por kërkon të ndryshoj me qëllim adresimin e tyre. Gjithashtu, evidentohet kjo edhe përmes një rasti të ilustruar për këtë kriter në RVB, ku bazuar në urdhrin e Rektorit Nr. 123 të datës 19.12.2019 është ngritur një grup pune në nivel institucional me qëllim përmirësimin e pyetësorit të studentëve për cilësisë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Financë” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Ismail Qemali” Vlorë

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni ka një historik veprimtarie relativisht të gjatë, është i konsoliduar dhe me një reputacion të mirë.
2. Vendndodhje strategjike dhe infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e procesit të mësimdhënies.
3. Programi i studimit plotëson kriteret ligjore për një program studimi të Nivelit të Parë.
4. Mbështetje e pakursyer në fonde monetare, kohë dhe fleksibilitet që jep Senati Akademik, Rektorati dhe BA për aplikimin dhe angazhimin e stafit të UV-së për të marrë pjesë në konferenca shkencore, projekte kërkimore dhe zhvëllimore.
5. Stafi i njësive mbështetëse në IAL, shumë i angazhuar dhe i gatshëm për çdo nevojë të studentëve dhe stafit të këtij programi studimi me qëllim rritjen e cilësisë dhe mbi të gjitha të vetëdijshëm për nevojat për përmirësim, duke mos u përpjekur të justifikoheshin apo ti mbulonin ato nga GVJ.
6. Zhvillimi, në dy vitet e fundit akademike për çdo semestër, të anketimeve të studentëve të programit Bachelor në “Financë” për vlerësimin e cilësisë së programeve mësimore si dhe matjen dhe vlerësimin e mësimdhënies bazuar në pyetësorë duke identifikuar problematikat, pikat e forta dhe të dobëta sipas vlerësimit të studentëve.
7. Respektimi i kërkesave e standardeve duke siguruar transparencë për publikimin edhe në faqen web të UV-së të 2 Raporteve (22 dhe 23) për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve, duke siguruar transparencë për studentët dhe të gjithë palët e interesuara.

Pika të dobëta:

1. Mungesa e praktikës profesionale në program.
2. Ngarkesa mësimore relativisht e lartë për pothuajse gjithë stafin akademik të programit, rrjedhojë kjo nga numri i lartë i moduleve që zhvillojnë. Kapërcim i ngarkesës normale mësimore në auditor deri në kufijtë maksimale (ndonjëherë edhe përtej këtij kufiri) për stafin akademik të angazhuar në këtë program ka dobësuar cilësinë për këtë program dhe

²² <https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/>.

²³ <https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/>.




- mundësinë e PAE-ve për t'ju përkushtuar projekteve kërkimore dhe zhvillimore dhe angazhimin e studentëve të tyre në këto projekte. Në këtë mënyrë orët e mësimin në auditor janë e vetmja mundësi për gjenerimin e të ardhurave për pedagogët. Ndërsa përmes projekteve përfitojnë të gjithë pretendentët përfshirë këtu pedagogët, studentët dhe vetë IAL.
3. Mungesa e llogaritjes së kostos për student për këtë program studimi, nuk mundëson kryerjen e analizave për vetë njësinë bazë dhe IAL-në duke ditur se referuar të dhënave publike të IAL-së evidentohet rënie e theksuar për të tretin vit radhazi të studentëve të rregjistruar në këtë program studimi (Studentët e rregjistruar në vitin akademik 2019-2020 janë sa 38% e studentëve të regjistruar në vitin akademik 2016-2017).
 4. Ngritja e pjesëshme nga UV e strukturave të nevojshme për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, është në mos plotësim të kërkesave të statutit të tij (neni 22) pasi ende nuk janë përzgjedhur anëtarët e komisioneve të përhershme në nivel institucional dhe në nivel të njësisë kryesore, respektivisht KSBCI dhe KSBCF.
 5. Mungesa e një studimi tregu të kryer në vitet e fundit, për këtë program studimi, studimi i fundit i tregut është kryer në vitin 2011, që do të thotë se të gjitha ndryshimet e bëra në këtë program gjatë këtyre 8 viteve të fundit nuk janë iniciuar dhe mbështetur nga analiza e tregut apo në një analizë të rekomandimeve të marra nga ALUMNI apo bizneset.
 6. Prezenca e ulët në media e stafit të këtij programi studimi, pavarisht përpjekjeve të bëra deri më tani nga UV, dhe mos përfshirja e tyre në projekte kërkimore apo zhvillimore kombëtare apo ndërkombëtare të cilat mundësojnë prezencë më të gjerë mediatike nuk ndërton imazh në rritje për një publik të gjerë dhe për më tepër për një program studimi i cili synon të tërheqë studentë përtej lokacionit të tij fizik. Risku i tregut dhe ai reputacional ndikojnë shumë në procesin e përzgjedhjes së programit dhe IAL-së nga kandidatët për studentë dhe prindërit e tyre.
 7. Kapacitete të kufizuara laboratorike për këtë program mësimor dhe mungesë të ambienteve rekreative dhe internetit në këto ambiente për studentët.
 8. Mungesa e programeve të veçanta lidhur me metodat e mësimdhënies bashkëkohore apo pedagogjike sidomos për anëtarët e stafit të programit që zotërojnë gradën shkencore “Doktor” apo diplomën Master i Shkencave.
 9. Ndryshimi në masë të konsiderueshme i kriterëve për rekrutim nga një rast në rastin tjetër të kërkuara nga e njëjta njësi bazë për të njëjtën kategori si edhe procesi i miratimit të kriterëve, i ndryshëm nga radha e përcaktuar në Nenin 51 të Statutit të UV-së, rezulton në një numri të ulët të kandidatëve (përgjithësisht 2 deri në 3 kandidatë) për pozicion pune të shpallur për PAE.




10. Mungesa e përfshirjes së stafit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi në projekte të institucioneve të pushtetit dhe qeverisjes lokale.
11. Numri relativisht i ulët i bashkëpunimit me Universitete homologe në fushën e programit të studimit.
12. Mungesa e aplikimit edhe të disa metodave dhe instrumenteve të tjera të standardizuara, krahas metodave të aplikuara nga IAL, për vlerësimin dhe ndërtimin e qëndrueshëm të cilësisë së këtij programi studimit.

Rekomandime:

1. Përshtatja më e mire e programit në funksion të tregut të punës nëpërmjet futjes në program të praktikës profesionale dhe “lehtësimit” të tij nga lëndë kryesisht teorik shkencore.
2. IAL të marre masat për lehtësimin e ngarkesës me orë mësimore në auditor të PAE-ve dhe nxitjen e tyre drejt hartimit dhe përfshirjes në projekte kërkimore dhe zhvëllimore ndoshta edhe përmes aplikimit të mekanizmave para-konvencionalë që stafi akademik dhe zyrat përkatëse të jenë aktiv dhe eficient në aplikimin dhe fitimin e projekteve, pasi kjo do të ishte një strategji e mirë për gjenerimin e të ardhurave shtesë për pedagogët, vetë IAL-në, si edhe përfshirjen e studentëve në tregun e punës.
3. Përderisa IAL financohet kryesisht nga buxheti i shtetit (Grandi që akordohet prej MASR) duhet që gjatë hartimit të planit financiar dhe buxhetit të UV-së të merret në konsideratë analiza e kostos për student në çdo program studimi sipas njësive bazë që mbulojnë programin. Bazuar në këtë analizën të hartohen objektivat, alokohen burimet financiare dhe njerëzore si edhe të ngarkohen ato me detyra dhe përgjegjësitë përkatëse me qëllim menaxhimin me efektivitet të burimeve të financimit të IAL-së.
4. Të merren menjëherë masat për zgjedhjen e anëtarëve dhe funksionimin e plotë të KSBCI dhe KSBCF, me qëllim zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve mësimore.
5. Të merren masa për kryerjen e një studimi tregu me qëllim që ndyshimet e mundshme në programin e studimit të iniciohen duke ju referuar studimit të tregut aktual dhe jo atij të 8 viteve më parë.
6. UV dhe në veçanti stafi i këtij programi studimi duhet të jetë akoma më shumë i pranishëm në medime komunikimi duke përcjellë imazh dhe reputacion të lartë për publikun të cilët influencojnë edhe rritjen e kërkesës për regjistrime në këtë program. UV duhet të punojë për evidentimin bazuar në fakte të një reputacioni në ngritje të tij, përndryshe risqet që UV është




e ekspozuar do të vijojnë të influencojnë tendenca rënëse të studentëve të regjistruar në këtë program dhe kështu kërcënohet edhe jetëgjatësia e këtij programi studimi.

7. Të marren masat për rritjen e kapaciteteve laboratorike për këtë program studimi ndoshta përmes aplikimit në projekte siç ka praktika të mira nga IAL të tjera publike apo nga vetë njësitë e tjera të UV. Gjithashtu, një rekomandim i thjeshtë për tu realizuar por ende i porealizuar është dedikimi i ambienteve të posaçme rekreative dhe internetit në këto ambiente për studentët.
8. Institucioni duhet të bëjë të zbatueshëm udhëzimin mbi metodat e mësimdhënies qoftë edhe duke organizuar seminare me fokus rritjen e nivelit pedagogjik dhe kompetencave didaktike për stafin e programit që ka marrë vitet e fundit gradën shkencore “Doktor” apo kanë përfunduar diplomimin në programin Master i Shkencave.
9. Referuar eksperiencave të mira që ekzistojnë, IAL duhet të ketë një rregullore për rekrutimin e stafit të UV ku të pasqyrohen kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta për kategoritë asistent lektor, lektor dhe profesor me qëllim që në procesin e rekrutimit, njësia bazë dhe gjithë strukturat e tjera përfshirë këtu edhe sektorin përgjegjës të rekrutimit të kujdesen rigorozisht për respektimin e neneve të rregullores dhe në përputhje me Statutin e UV-së.
10. IAL e ka të nevojshme ndërtimin e një bashkëpunimi real me institucionet e pushtetit dhe qeverisjes lokale për të siguruar angazhimin e stafit dhe studentëve të këtij programi studimi në projekte kërkimore dhe zhvillimore të cilat do të sjellin përfitim për të gjitha palët. Praktika të tilla të mbështetjes së fortë të universiteteve nga institucionet e pushtetit dhe qeverisjes lokale i ndeshim në të gjitha qytetet universitare në vendet e Evropës Perëndimore, por edhe në Shqipëri.
11. Rekomandohet rritja e bashkëpunimit me Universitetet homologe në kuadër të programit të studimit.
12. Përveç metodave që aplikon, i sugjerohet IAL-së të konsiderojë edhe metoda dhe instrumente të tjera të standardizuara të cilat ndihmojnë vlerësimin dhe ndërtimin e qëndrueshëm të cilësisë së programit të studimit, disa të tilla mund të jenë:
 - a) Rishikimi i syllabuseve, kurrikulave dhe procesit mësimor, çdo semestër të iniciohet nga Rektorati në drejtim të njësisë bazë dhe kryesore me qëllim analizën dhe azhurnimin e tyre bazuar në studimet dhe nevojat e tregut, dhe opinionet e aktorëve të tjerë si ALUMNI, Bizneset, etj. Procesi mësimor dhe përmirësimi i tyre janë përgjegjësi jo vetëm e njësisë bazë dhe asaj kryesore por edhe e zv.rektorit që mbulon anën mësimore, si edhe zyrat e tjera në IAL të cilat duhet të japin dakordësinë e tyre para se të kërkohet dhe merren vendime nga Senati Akademik me qëllim mirëmenaxhimit, testimin dhe kontrollin e tyre në vazhdimësi;




- b) Vlerësimi 360 gradë si një teknikë koherente perëndimore e aplikueshme për vlerësimin e eprorëve, kolegëve dhe vartësve në universitete.
13. Rekomandohet ulja e numrit të lëndëve që zhvillon një pedagog në këtë program studimi në jo më shumë se 3 të tilla të së njëjtës fushë.
14. Në kuadër të hapësirave ligjore dhe nënligjore të ndryshimeve në kurrikul, në vitet e ardhshme të mund të shihet mundësia e zëvendësimit/ndryshimit të 2 deri 3 lëndëve (të përmendura në raport) që janë disi larg fushës së programit apo janë kryesisht teorike shkencore (ndoshta për një program Master i Shkencave), me lëndë të karakterit profesional.
15. IAL të ndërtojë një procedurë të kontrollit dhe manaxhimit të standardizuar përmes kanaleve përkatëse me qëllim përmirësimin e procesit por edhe rritjen e cilësisë për kryerjen e ndryshimeve në planet mësimore. Mund të mbahen në konsideratë praktikatat e kryera nga vetë IAL në të shkuarën. (sipas Aneksit 1.8).





Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in "Finance" of the Institution of Higher Education, University "Ismail Qemali" Vlora

Strengths and affirmations:

1. The institution has a relatively long history of activity, is consolidated and has a good reputation.
2. Strategic location and appropriate infrastructure for the development of the teaching process.
3. The study program meets the legal criteria for a First Level study program.
4. Unsparing support in monetary funds, time and flexibility provided by the Academic Senate, the Rectorate and the BA for the application and engagement of UV staff to participate in scientific conferences, research and development projects.
5. Staff of support units in HEIs, is very committed and ready for any need of students and staff of this study program in order to increase quality and above all, they are aware of the needs for improvement, not trying to justify themselves or cover them from EEG.
6. Development in the last two academic years for each semester, of Finance program Bachelor students' surveys for assessing the quality of curricula and measuring and evaluating teaching based on questionnaires, identifying problems, strengths and weaknesses according to students assessment.
7. Respecting the requirements of the standards by ensuring transparency for the publication on the website of the UV of 2 Reports (22 and 23) and for the analysis of the results of the questionnaires from the students surveys, providing transparency for students and all stakeholders.

Weaknesses:

1. Lack of professional practice in the program.
2. Relatively high teaching load for almost all academic staff of the program, resulting from the high number of modules they teach. Overcoming the normal teaching load in the auditorium up to the maximum limits (sometimes even beyond this limit) for the academic staff engaged in this program has weakened the quality of this program and the possibility of EAP to dedicate themselves to research and development projects and the commitment of their students in these projects. In this way, teaching hours in the auditorium are the only way to generate income for pedagogues. While through the projects all the contenders benefit, including the professors, the students and the HEI itself.

3. The lack of cost calculation per student for this study program does not enable the analysis of the basic unit and the HEI, knowing that referring to the public data of the HEI, there is a significant decrease for the third consecutive year of students enrolled in this study program (Students enrolled in the academic year 2019-2020 are as much as 38% of students enrolled in the academic year 2016-2017).
4. The partial establishment by UV of the structures necessary for the Internal Quality Assurance, is in non-fulfillment of the requirements of its statute (Article 22) as the members of the permanent commissions at the institutional level and at the main unit level have not been selected yet, respectively IIQAC and FIQAC.
5. Lack of a market study conducted in recent years, for this study program the last study market has been conducted in 2011, which means that all changes made to this program during these last 8 years have not been initiated and supported by market analysis or in an analysis of recommendations received from ALUMNI or businesses.
6. The low media presence of the staff of this study program, despite the efforts made so far by UV, and their non-inclusion in national or international research or development projects which enable wider media presence does not build a growing image for a wider audience and moreover for a study program which aims to attract students beyond its physical location. Market and reputational risk greatly affect the program and HEI selection process by candidates for students and their parents.
7. Limited laboratory capacities for this study program and lack of recreational and internet facilities for students.
8. Lack of special programs related to contemporary teaching or pedagogical teaching methods, especially for study program staff members who hold the scientific degree "Doctor" or Master of Science degree.
9. Significant change of the criteria for recruitment from one case to another required by the same basic unit for the same category as well as the process of approval of the criteria, different from the order defined in Article 51 of the Statute of UV, results in a low number of candidates (generally 2 to 3 candidates) for the job position announced for EAP.
10. Lack of involvement of academic staff and students of this study program in projects of local government institutions.
11. Relatively low number of cooperation with counterpart Universities in the field of this study program.




12. Lack of application of some other standardized methods and instruments, in addition to the methods applied by HEI, for the evaluation and sustainable construction of the quality of this study program.

Recommendations:

1. Better adaptation of the program in function of the labor market through the introduction in the program of professional practice and its "relief" from mainly theoretical scientific subjects.
2. HEI should take measures to facilitate the load of teaching hours in the auditorium of EAPs and to encourage them towards drafting and involvement in research and development projects, perhaps also through the application of pre-conventional mechanisms for academic staff and relevant offices to be active and efficient in applying and earning projects, as this would be a good strategy for generating additional income for pedagogues, the HEI itself, as well as the involvement of students in the labor market.
3. While the HEI is financed mainly by the state budget (the Grand allocated by MESY), during the drafting of the financial plan and the UV budget, the cost analysis per student in each study program should be considered, according to the basic units that covers the program. Based on this analysis, the objectives should be drafted, the financial and human resources should be allocated, as well as the relevant tasks and responsibilities should be assigned in order to effectively manage the HEI funding sources.
4. Should be taken measures immediately for the selection of members and the full functioning of IIQAC and FICAQ, in order to implement the legal and regulatory framework in force, to guarantee continuous improvement of the quality of the study programs.
5. Measures should be taken to conduct a market study in order to initiate possible changes in the study program by referring to the current market study and not that of 8 years ago.
6. UV and in particular the staff of this study program should be even more present in the communication media by conveying high image and reputation to the public who influence the increase of the demand for enrollment in this program. UV should work on evidence based, on facts of a rising reputation, otherwise the risks that UV is exposed to will continue to influence the declining trend of students enrolled in this program and thus threaten the longevity of this study program.
7. Measures should be taken to increase the laboratory capacity for this study program, perhaps through application in projects, there are such good practices from other public HEIs or from




- other UV units themselves. Also, a simple recommendation to be realized but still unrealized is the dedication of special recreational facilities and internet in these facilities for students.
8. The institution should implement the instruction on teaching methods, even by organizing seminars with a focus on increasing the pedagogical level and didactic competencies for the study program staff that have received the scientific degree "Doctor" in recent years or have completed graduation in the Master of Science program.
 9. Referring to the good existing experiences, HEI should have a regulation for the recruitment of UV staff where to reflect the general and specific criteria for the categories of assistant lecturer, lecturer and professor in order that in the recruitment process, the basic unit and all other structures, including the responsible recruitment sector, to take strict care of compliance with the articles of the regulation and in accordance with the UV Statute.
 10. HEI need to build a real cooperation with local government institutions to ensure the commitment of staff and students of this study program in research and development projects that will bring benefits to all parties. We encounter such practices of support from local government institutions in all university cities in Western European countries, but also in Albania.
 11. HEI is recommended to increase the cooperation with the counterpart Universities for this study program.
 12. In addition to the methods applied, it is suggested to the HEI to consider other standardized methods and instruments that help assess and build sustainable quality of the study program, some of which may be:
 - a) The review of syllabuses, curricula and teaching process, each semester, to be initiated by the Rectorate towards the basic and main unit in order to analyze and update them based on market studies and needs, and the opinions of other actors such as ALUMNI, Businesses, etc. The teaching process and their improvement are the responsibility not only of the basic and main unit but also of the vice-rector who covers the teaching side, as well as other HEI offices who must give their consent before requesting and making decisions by the Academic Senate for the purpose of their continuous management, testing and control;
 - b) 360 degree evaluation as a coherent western technique applicable to the evaluation of superiors, colleagues and subordinates in universities.
 13. HEI is recommended to reduce the number of subjects developed by a lecturer in this study program, in no more than 3 of the same field.

14. Within the legal and sub-legal spaces of changes in the curriculum, in the coming years should be considered the possibility of replacing / changing 2 to 3 subjects (mentioned in the report) that are somewhat far from the field of the program or are mainly scientific theoretical (perhaps for a Master of Science program), with professional subjects.
15. HEI should build a standardized control and management procedure through relevant channels in order to improve the process but also increase the quality of changes in curricula. There are good practices conducted by the HEI itself in the past that can be considered. (According to Annex 1.8).



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përmbushen plotësisht	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	